

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P.Nr. 516/08

Data 16 mars 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë

- 1) Gjyqtari i EULEX-it Z. Francesco FLORIT, Kryetar i Trupit Gjykses
- 2) Gjyqtari i EULEX-it, Z Andrea CRUCIANI, anëtar i Panelit
- 3) Gjyqtar Vendor, Z Sulejman NUREDINI, anëtar i Panelit

Me procesmbajtëset Valentina Gashi dhe Liz Bateman.

Në lëndën penale kundër:

BURIM BERISHËS: djali i Rrahim dhe Hasime (mbiemri i vajzërisë Rexha), lindur me datë 12.04.1981 në Shkup, Republika e Maqedonisë, me vendqëndrim në Ferizaj, rruga "13 Qershori", i martuar, me dy fëmijë, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale, krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur më veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK; dhe gjithashtu i akuzuar për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 2 i KPK.

Haki ISUFI, djali i Nazif dhe Zyrije (mbiemri i vajzërisë Shaliti) lindur me datë 12.04.1963 në fshatin Tërpeza, komuna e Vitisë ku ai qëndron, baba i tre fëmijëve, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale, krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur më veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK;

Fikret MURATI, djali i Ramadanit dhe Sevdije (mbiemri i vajzërisë Sherifi), lindur me datë 24.04.1983 në fshatin Tërpeza, komuna e Vitisë ku ai qëndron, i martuar, një fëmijë, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur më veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK;

Fatos AZIZI, djali i Jahës dhe Bahrije (mbiemri i vajzërisë Azemi) lindur me datë 06.10.1977 në fshatin Kabash komuna e Vitisë ku ai qëndron, i martuar, pesë fëmijë, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur më veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK;

Selami BEQIRI, djali i Dalipit dhe Taibes (mbiemri i vajzërisë Ademi) lindur me datë 20.11.1968 në fshatin Sllatina e Epërme komuna e Vitisë ku ai qëndron, i martuar, katër fëmijë, ka mbaruar shkollën fillore, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur me veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK;

Faruk ADEMI, djali i Mahmutit dhe Nevrijes (mbiemri i vajzërisë Hoxha), lindur me datë 07.06.1974, në Gjilan, jeton në fshatin Kabash, komuna e Vitisë, i martuar, tre fëmijë, Shqipëtar, qytetar e Republikës së Kosovës, aktualisht në paraburgim; i akuzuar për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 i KPK lidhur me veprën penale të grabitjes sipas nenit 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK;

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor public me datë 15 dhe 26 janar 2009, 6 dhe 24 shkurt 2009, dhe 09, 10 dhe 13 mars 2009, në prani të të akuzuarve të lartpërmendur, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurores Publike Sevdije MORINA;

Duke marrë parasysh ndryshimet e aktakuzës të propozuara nga Prokurori Publik me datë 10 mars 2009;

Pas shqyrtimit të Panelit për marrjen e vendimit me datë 16 mars 2009;

Bazuar në nënin 391 (1) të KPK

Në prani të publikut, të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurores Publike ka shpallur si në vijim:

AKTGJYKIM

1) të gjithë të akuzuarit e lartpërmendur

Lirohen

nga akuzat për « krim të organizuar » përkufizuar në nënin 274 (1) të KPK ;

2) Të gjithë të akuzuarit e lartpërmendur

Shpallen fajtorë

Për veprën penale të « grabitjes » në kundërshtim me nenin 255 (2) lidhur me (1) të KPK në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK për të akuzuarit Burim BERISHA, Haki ISUFI, Fikret MURATI, Fatos AZIZI dhe Faruk ADEMI dhe me ndihmën e Selami BEQIRIT, sipas nenit 25 të KPK ;

3) I akuzuari Burim BERISHA

Shpallet fajtor

Për veprën penale të « posedimit të paautorizuar të armëve » në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPK;

DËNIMI

Burim BERISHA

Në pajtim me nenin 38 të KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 23 të KPK dënohet me 5 vjet dhe 6 muaj burg ;

Në pajtim me nenin 38 të KPK dhe nenin 328 (2) të KPK dënohet me 1 vjet burg ;

Në pajtim me nenin 71 KPK dënimi unik është 6 vjet burg.

Haki ISUFI

Në pajtim me nenin 38 KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 23 të KPK dënohet me 5 vjet burg.

Fikret MURATI,

Në pajtim me nenin 38 KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 23 të KPK dënohet me 2 vjet burg.

Fatos AZIZI,

Në pajtim me nenin 38 KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 23 të KPK dënohet me 4 vjet dhe 6 muaj burg.

Selami BEQIRI,

Në pajtim me nenin 38 KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 25 të KPK dënohet me 2 vjet dhe 6 muaj burg.

Faruk ADEMI,

Në pajtim me nenin 38 KPK dhe nenin 255 (1), (2) dhe 23 të KPK dënohet me 4 vjet dhe 6 muaj burg.

Për gjithë të akuzuarit, koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e secilit prej të pandehurve.

KËRKESË PËR DËMSHPËRBLIM

Të akuzuarit, në mënyrë të përbashkët do të kompensojnë palën e dëmtuar (Pro Credit Bank) për dëmet e shkaktuara të cilat të përcaktuara, pas kërkesës, në 44.742,11 euro dhe 4900 \$.

KONFISKIMI

Në pajtim me nenin 60 të ÇP dhe KÇP konfiskohen, revolveri i markës Ceska Zbrojevka, model VZOR 50 i kalibrit 7,65x17mm, numri i serisë D-30238, prodhim Cek; 15 plumba të kalibrit 15mm; makina Volksäagen model Golf, numri i regjistrimit 202 KS 943 dhe makina Opel, model Vectra, numri i regjistrimit 344 KS 315.

ShPENZIMET.

Të pandehurit Burim BERISHA, Haki ISUFI, Fikret MURATI, Fatos AZIZI, Selami BEQIRI dhe Faruk ADEMI duhet të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas një liste të harxhimeve e cila do të përcaktohet në kohë të duhur.

Të pandehurit janë të detyruar të kompensojnë harxhimet e përgjithshme të procedurës që janë përcaktuar në vlerën prej 500 euro.

ARSYETIMI

RRJEDHA E PROCEDURËS.

Me datën 12 qershor 2008, është vendosur paraburgimi kundër të gjithë të pandehurve me anë të një vendimi të Gjyqtarit të Procedurë Paraprake në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, PPH nr.192/08. Pastaj, gjatë hetimeve dhe fazës së konfirmimit, paraburgimi për të gjithë të pandehurit është zgjatur në mënyrë të ligjshme.

Me datën 25 gusht 2008, Prokurori Publik ka ngritur aktakuzën, PP nr. 456-6/2008, me Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurve të lartpërmendur për veprat penale në vijim:

I. Të pandehurit Burim BERISHA, Haki ISUFI, Fikret MURATI, Fatos AZIZI, Selami BEQIRI dhe Faruk ADEMI.

Kanë kryer vepër të rëndë penale si pjesë e grupit të organizuar kriminal me qëllim të përfitimit direct financiar dhe material, në mënyrë të tillë që të pandehurit Burim Berisha dhe Haki Isufi kanë bërë një plan paraprak për të grabitur filialin ProCredit Bank në Ferizaj dhe pasi kanë bërë planin ata kanë kontaktuar të pandehurin Fikret Murati të cilit i kanë kërkuar të gjejë një person të besueshëm i cili do të futej në bankë së bashku me të pandehurin Burim; kështu i pandehuri Fikret ka kontaktuar të pandehurin Xhelal Abazi, i cili gjendet në arrati. Pasi ky vetë ka pranuar propozimin, të katër janë takuar me njëri tjetrin në kafeterinë "Road 66" në Ferizaj ku ata kanë ndarë rolet për secilin prej tyre duke përfshirë edhe të pandehur të tjerë të cilëve ata u kanë ndarë role, dhe të informuar për kohën e kryerjes së veprës penale; kështu me datë 9 qershor 2008, në orën 08:06 minuta, me makinën "Golf II" ngjyrë e gjelbër, me targa 202 KS 943, pronë e të pandehurit Selami Beqiri i cili pas marrëveshjes me të pandehurit Haki Isufi dhe Selami Beqiri, ka lënë makinën në oborrin e shtëpisë së tij, të hapur, me çelësa brenda. Të pandehurit Burim Berisha dhe Xhelal Abazi kanë shkuar përballë Bankës, e cila gjendet në rrugën "Vëllezërit Gërvalla", në Ferizaj, kanë ndaluar makinën, kanë dalë nga makina, të maskuar, me dorëza pune dhe te armatosur me revolver që e mbanin në dorë. Shpejt ata kanë hyrë brenda ku i pandehuri Xhelal ka drejtuar revolverin drejt rojeve të sigurisë në hyrje të ndërtesës duke i detyruar ata të shtrihen në dysheme duke i kërcënuar se nëse lëviznin do të vriteshin, ndërsa i pandehuri Burim Berisha me revolver ka shkuar tek zyra e parave dhe duke i kërcënuar at me revolver ka marrë nga fjoka gjithë paratë, ka futur ato në çantën boshe të bankës, ka marrë një çantë tjetër dhe e ka mbushur me paratë, pastaj që të dy kanë dalë nga banka dhe janë larguar shumë shpejt me të njëjtën makinë dhe me këtë rast ata kanë marrë sasinë e parave prej 111.182,91 euro, 196.889 USD dhe 40 franga zvicerane. Kur ata kanë mbërritur në Qendrën Mjekësorë Rajonale në Ferizaj, ashtu siç kishin bërë marrëveshje më përpara, i pandehuri Faruk Ademi ishte duke i pritur me makinë e tij, ngjyrë qershie "Opel Vectra" me targa 344 KS 315 sipas marrëveshjes së mëparshme me të pandehurin Fatos Azizi. I pandehuri Haki Isufi i kishte premtuar atij për këtë 10.000 euro nga të cilat 1000 euro do të jepeshin pronarit të makinës. Ata kanë vendosur çantat me para në makinë, i pandehuri Xhelal Azizi ka hyrë dhe kanë rrugëtuar me shpejtësi drejt Gjilanit ndërsa i pandehuri Burim Berisha ka marrë një taksit dhe ka shkuar në restoration "Buca Petrol" në rrugën kryesore Ferizaj-Kacanik ku ai ka pirë një kafe. Ai ka bërë disa telefonata nga telefonat e kamarierëve dhe në fund ai ka hedhur revolverin në koshin e plehrave në koridorin e banjës. Në anën tjetër, të pandehurit Xhelal dhe Faruk kanë vazhduar me makinë në drejtim të pyllit, afër fshatit Zllatar. Ata kanë marrë çantat me para dhe janë larguar deri afër fshatit Tërpeze ku ata kanë vendosur paratë në çanta sportive ngjyrë qershie. I pandehuri Xhelal ka marrë një sasi parash pas premtimit të mëparshëm i ka dhënë të pandehurit Faruk 3000 euro dhe 5100 USD dhe ata janë ndarë këtu. Pas ndarjes i pandehuri Xhelal Azizi është takuar me të pandehurit Fikret dhe Haki ku i pandehuri Fikret ka fshehur çantën e mbushur me para nën kulmin e shtëpisë së xhaxhait të tij, ndërkohë të pandehurit Burim Berisha, Haki Isufi dhe Fatos Azizi janë takuar në kafeterinë "Energji" ku janë arrestuar nga policia. Më vonë janë arrestuar të tjerët ndërsa i pandehuri Xhelal Azizi ka ikur dhe ka marrë me vete 40.000 euro.

- Me këtë ata do të kenë kryer (shkruar me dorë sipër do të kishin bërë) një vepër penale të organizuar nga nenin 274 paragrafi 1 i KPPK, lidhur me veprën penale nga neni 255 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK.

II. I pandehuri Burim Berisha.

Nga një datë e paverifikuar deri me datën 11.06.2008, ka mbajtur pa autorizim një revolver të një marke të panjohur, e përdorur gjatë kryerjes së veprës penale, grabitje, me datë 09.06.2008 dhe pasi ka kryer vepër penale ai ka shkuar në kafeterinë "Buca Petrol" në rrugën kryesore Ferizaj-Kacanik. Ai ka hedhur revolverin në koshin e plehrave në koridorin e banjos të cilin e ka gjetur dhe konfiskuar policia me datë 11.09.2008

- Me këtë ata do të ketë kryer (shkruar me dorë sipër do të kishin bërë) veprën penale të mbajtjes në pronësi, posedimit dhe përdorimit të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2 i KPPK.

Pastaj aktakuza është konfirmuar me datë 20 tetor 2008 me anë të një vendimi të Gjyqtarit Konfirmues në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, KA.nr.495/2008.

Me datën 15 janar 2009, ka filluar shqyrtimi kryesor. Ka qenë të pranishëm, anëtarët e Trupit Gjykses të lartpërmendur; të pandehurit Burim Berisha dhe avokati i tij mbrojtës Avni Ibrahim; Haki Isufi dhe avokati i tij mbrojtës Aziz Rexha; Fatos Azizi dhe avokati i tij mbrojtës Shemsedin Piraj; Selami Beqiri dhe avokati i tij mbrojtës Bajram Krasniqi; Faruk Ademi dhe avokati i tij mbrojtës Sahit Musa. I pranishëm ka qenë edhe Jakup Hoti, përfaqësues i ProCredit Bank.

Kryetari i Trupit Gjykses ka konfirmuar se paneli është përbërë në pajtim me ligjin. Juridiksioni i Gjyqtarëve të EULEX-it në këtë lëndë bazohet në dispozitat e nenit 3 të ligjit Nr. 03/L-053 mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë dhe nenin 5 të ligjit Nr. 03/L-052 mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të cilët parashohin përkatësisht se "*Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë mbi çdo lëndë që hetohet apo ndiqet nga PSRK*" dhe se "*PSRK do të ketë kompetencë ekskluzive për të hetuar dhe ndjekur krimet në vijim, edhe në tentativë, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit për krimet e (...) krimet të organizuar (Neni 274, KPPK)*". Nuk ka pasur kundërshtime nga palët në lidhje me përbërjen e panelit.

Gjatë së njëjtës seancë, pas leximit të secilës pikë të aktakuzës nga Prokurori Publik, të pandehurit janë pyetur të deklarojnë fajtor apo të pafajshëm. Gjithë të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.

Në lidhje me kërkesat e avokatëve mbrojtës paneli ka vendosur se nuk ka arsye të mendohet gjendja mendore e të akuzuarve Selami Beqiri dhe Fikret Murat i pengonte këta të fundit që të ndiqnin rrjedhën e procedurës penale, meqënëse dokumenti i siguruar

nga avokatët mbrojtës mbi këtë çeshtje nuk tregojnë ndonjë kundërshtim apo mangësi të rënda të gjendjes mendore të të akuzuarve.

Në lidhje me çeshtjen e ngritur gjithashtu nga avokatët mbrojtës mbi dështimin e Prokurorit për të zbuluar gjithë dokumentacionin, përjashtimi është refuzuar sepse nuk ishte ngritur gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës dhe kështu konsiderohet se palët kanë qenë të kënaqura me dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori Publik.

Gjykata ka gjetur gjithashtu se dëshmitarët dhe provat e tjera të ofruara nga Prokurori Publik dhe avokatët mbrojtës pranohen.

Në të njëjtën datë është ekzaminuar dëshmitari Qerim Jaha.

Me datë 26 janar 2009, janë ekzaminuar dëshmitarët

N. H. H. A.

CD-ja që përmbante regjistrimet e grabitjes së bankës që ka ndodhur në ProCredit Bank me datë 9 qershor 2008 është lëshur dhe shikuar nga gjithë të pranishmit në sallën e gjyqit.

Me datën 6 shkurt 2009 janë ekzaminuar dëshmitarët

Me datën 24 shkurt është ekzaminuar dëshmitari I. H.

Prokurori Publik i ka ofruar Panelit një document me titull: Formulari i Ekzaminimit të Laboratorit të Forensikës, Nr. 456-6/08 i datës 6 shtator 2008.

Ekzaminimi i të pandehurve Burim Berisha, Haki Isufi dhe Fatos Azizi është bërë ndërsa Fikret Murati ka vendosur të qëndrojë në heshtje.

Me datën 9 mars 2009 janë ekzaminuar dëshmitarët e tjerë Selami Beqiri dhe Faruk Ademi.

Me datën 10 mars 2009 pasi që Kryetari i Trupit Gjyqësor ka dhënë një përmbledhje të deklaratave të të akuzuarve, është bërë një ballafaqim mes dy të akuzuarve Haki Isufi dhe Fatos Azizi. Janë renditur dokumentet që do të konsiderohen si prova të pranueshme. Prokurori Publik ka vazhduar me ndryshimet e aktakuzës si në vijim: "Së pari, në lidhje me të dhënat personale të të akuzuarit Burrim Berisha, kam harruar fjalët: "kundër tij është në vijim një procedurë për mashtrim", për të akuzuarin Fikret Murati dhe Fatos Azizi kam harruar fjalët: " të dyshuar për vepra të tjera penale". Në dispozitat e aktakuzës në vend të emrit Xhelal Abazi duhet të jetë emir Xhelal Azizi. Pastaj fjalët "sipas marrëveshjes me të pandehurit Haki Isufi dhe Selami Beqiri" duhet të jetë "sipas marrëveshjes me të pandehurin Haki Isufi" dhe në fund, në lidhje me këtë dispozitë në rreshtat e fundit, ku shkruhet për arrestimin e të pandehurve, emir i Haki Isufit duhet të zëvendësohet me emrin e të pandehurit Fikret Murati. Në dispozitën numër II në vend të fjalëve: "revolver i markës së panjohur" duhet të jetë "revolveri i markës Ceska

Zbrojevka, model VZOR 50 i kalibrit 7,65x17mm, numri i serisë D-30238, prodhim Cek” dhe në fund të përshkrimit në fjalë shtoj fjalët “dhe pas kontrollit të makinës së tij “Alfa Romeo” janë gjetur dhe konfiskuar edhe 15 plumba të kalibrit 15mm të cilët ai i mbante pa autorizim”.

Janë paraqitur fjalët përfundimtare të Prokurorit Publik, përfaqësuesit të autorizuar të Palës së dëmtuar Pro Credit Bank, dhe të avokatit mbrojtës të Selami Beqirit.

Me datën 13 mars 2009. janë paraqitur fjalët përfundimtare të palëve të mbetura.

Me datën 16 mars 2009, Gjykata është tërhequr për marrjen e vendimit. Pas deliberimit dhe votimit, Gjykata ka shpallur dispozitën e këtij aktgjykimi të shkruar më lart.

CILËSIMI I LËNDËS

1. Shfaqësimi i të gjithë të pandehurve për akuzën për krim të organizuar.

Gjithë të pandehurit janë akuzuar në aktakuzë për veprën penale të krimit të organizuar. Prokurori Publik ka pohuar se gjithë të pandehurit kanë qenë anëtarë aktiv të një organizate kriminale. Megjithatë, Prokurori Publik, mbi të cilin bërë pesha e provave, sipas nenit 10 paragrafi 3 i KPPK, ka dështuar në mbështetjen më ndonjë provë të ekzistencës së një organizate të tillë kriminale.

Neni 274, paragrafi 1 dhe 2 të KPK inkrimojnë përkatësisht *“cilido kryen një krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal” (paragrafi 1) dhe “cilido merr pjesë aktivisht në aktivitete kriminale apo të tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të ndihmojë në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar” (paragrafi 2).* Neni 274, në paragrafin 7 vazhdon duke dhënë përkufizimet ligjore të termave relevantë të përmendur në paragrafët e mësipërm. Në veçanti, termi *“krim i organizuar”* do të thotë krim i rëndë i kryer nga një grup i strukturuar me qëllim përfitimin financiar apo material direkt apo indirekt; Termi *“grup i organizuar kriminal”* do të thotë një grup i strukturuar që ekziston për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkësi për kryerjen e një apo më shumë krime të rënda me qëllim përfitimin financiar apo material direkt apo indirekt; termi *“krim i rëndë”* do të thotë një veprë që ndëshkohet me të paktën 4 vjet burg; termi *“grup i strukturuar”* do të thotë i përbërë nga tre ose më shumë persona që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe nuk ka nevojë të ketë role të përcaktuara në mënyrë formale për pjesëtarët e tij, vazhdimësia e antarësisë apo një strukturë e zhvilluar.

Tani, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 274 të KPK, mund të pohohet se për të kryer një krim të organizuar nevojiten elementet në vijim: 1) elementi material (actus rei) që është kryerja e një krimi të rëndë (që ndëshkohet me të paktën 4 vjet burg) si pjesë e një grupi të organizuar kriminal apo pjesëmarrja në aktivitetet kriminale apo të tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të ndihmojë në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar; 2) ekzistenca e një grupi të

organizuar kriminal, që do të thotë një grup i strukturuar – një grup prej tre apo më shumë personash që nuk është formuar rastësisht, për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe nuk ka nevojë të ketë role të përcaktuara në mënyrë formale për pjesëtarët e tij, vazhdimësia e antarësisë apo një strukturë e zhvilluar - që ekziston për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkësi për kryerjen e një apo më shumë krime të rënda me qëllim përfitimin financiar apo material direkt apo indirekt; 3) elementi psikologjik (*mens rea*) në formën e një qëllimi të cilësuar (*dolus specialis*) që do të thotë njohuria se kryerja e një krimi të rëndë (*id est*, vepra e përbërë) apo pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal është bërë në bashkërendim me anëtarët e tjerë të grupit të përmendur për kryerjen e një apo më shumë krime të rënda me qëllim përfitimin financiar apo material direkt apo indirekt.

Gjykata vlerëson se Prokurori nuk ka siguruar Gjykatës informata të mjaftueshme në lidhje me ekzistencën e këtyre elementeve dhe se në veçanti nuk ka paraqitur gjykatës prova që sugjerojnë se të pandehurit kanë qenë pjesë e një grupi të organizuar kriminal. Në fakt, nuk janë paraqitur prova në lidhje me strukturën e grupit kriminal, kohën kur ai është formuar, kohën gjatë së cilës ai ka qenë aktiv, përfitimet nga aktivitetet kriminale dhe kështu me radhë. Përkundrazi, duket qartë nga mbledhja e provave gjatë shqyrtimit kryesor se grupi i cili ka kryer grabitjen e bankës është grup i formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të këtij krimi specifik, që nuk ka përbërë një grup të strukturuar që bien nën përkufizimin e nenit 274 paragrafi 4 i KPPK. Është e mjaftueshme të thuhet se jo të gjithë të pandehurit kanë njohur njëri tjetrin përpara kryerjes së krimit dhe grabitjes së bankës, dhe grabitja e bankës është përgatitur jo shumë përpara kryerjes së saj.

Si përfundim, duke marrë parasysh mungesën e plotë të provave në lidhje me akuzën për “Krim i Organizuar” sipas nenit 274 të KPPK, gjithë të pandehurit do të lirohen nga kjo akuzë.

2. Përgjegjësia penale e Burim Berishës.

Pas leximit të dosjes së lëndës, Gjykata është kënaqur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mbi përgjegjësinë penale të të pandehurit Burim Berisha në lidhje me veprën penale të “Grabitjes” në kundërshtim me nenin 255 (1) dhe (2) të KPK në bashkëkryerje sipas nenit 23 KPK dhe “Mbajtje në Pronësi, Posedim dhe Përdorim i Paautorizuar i armëve” në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPK.

2.1. Grabitje, në kundërshtim me nenin 255 (1) dhe (2) të KPK.

Përsa i përket akuzës për “Grabitje” përgjegjësia penale e Burim Berishës del në pah nga të gjitha provat e mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor, përkatësisht nga provat materiale dhe matja e thirrjeve telefonike.

Oficerët e policisë, Hetuesi Behar Ramadani dhe Komandanti rajonal në Ferizaj Isa Hyseni, të cilët janë thirrur të dëshmojnë në Gjykatë, kanë spjeguar rrjedhën e hetimit që

sjellur në identifikimin e të pandehurve. Në fund të shkurtit 2008, policia ka marrë informata të inteligjencës se i pandehuri Burim Berisha i cili në atë kohë punonte si mbikqyrës sigurimi për një kompani që siguronte ndihmë për sigurinë e Pro Credit Bank, së bashku me persona të tjerë të panjohur, ishte në prag të kryerjes së një grabitje banke. Policia ka aktivuar gjatë një jave një sistem mbikqyrje, por nuk është regjistruar ndonjë ngjarje kriminale gjatë asaj periudhe kohore. Me datën 9 qershor 2009, kur është bërë një grabitje banke në ProCredit Bank në Fshatin Gervalla, Ferizaj, vëmendja e menjëhershme e hetuesve të policisë është përaëndruar tek personi Burim Berisha. Menjëherë kanë vijuar du aktivitetet hetimore. Makina Alfa Romeo 471 – KS – 901, pronë e Burim Berishës është kontrolluar dhe në atë makinë janë gjetur 15 plumba. Për më tepër, hetuesit kanë kontaktuar shpejt të pandehurin në restorantin Buca Petrol ku dy ditë më vonë, me datë 11 qershor 2009 është gjetur një revolver në koshin e plehrave që gjendet në tualetin e restorantit. Pastaj, oficerët e policisë kanë ndjekur lëvizjet e të pandehurit Burim Berisha dhe ai është takuar në një bar në Viti me të pandehurit e tjerë Fikret Murati dhe Fatos Azizi ata i kanë arrestuar të gjithë. Fikret Murati ka bashkëpunuar shumë që në fillim duke dhënë hetuesve deklarata të rëndësishme të cilat kanë zbuluar rrjedhën e gjitha ngjarjeve. Bazuar në këtë informacion nga i bashkëakuzuari, policia ka shkuar të kontrollojë shtëpinë e Fikret Muratit në fshatin Tërpeze dhe ka identifikuar edhe Selami Beqirin dhe Faruk Ademin ndërsa Xhelal Azizi ka ikur përpara se të arrestohej.

Këtu në vijim kemi një pjesë të procesverbalit të ekzaminimit të dëshmitarit, hetues

██████████ B.R.

Kryetari i Trupit Gjykses: E kemi fjalën te incidenti që ndodhi më 9 qershor, në mëngjes në Ferizaj. Një grabitje e bankës ndodhi në Ferizaj. A mund të më thoni se si jeni përfshirë ju në këto hetime?

B.R. ██████████ Unë kam qenë i përfshirë. Por, një numër i madh policësh kanë qenë të përfshirë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë aktiviteti keni kryer ju?

B.R. ██████████ Më 9 qershor 2008, në orën 8 të mëngjesit, ne zakonisht mbajnë mbledhjen tonë të mëngjesit. Pas mbledhjes, e cila përfundoi rreth orës 8:20, Komandanti dhe Shefi i ftoi të gjithë Njësitë Hetimore.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si është emri i Komandantit?

B.R. ██████████ Isa Hyseni. Na është thënë që ka pasur një grabitje të armatosur në rrugën Vllezerit Gervalla, në degën e Pro Credit Bankës.

Pastaj, si procedurë të rregullt, kemi përpiluar planin operativ. Kjo detyrë na është caktuar mua dhe dy kolegëve. Tok bashku me Njësinë e Forenzikës, kemi shkuar të kontaktojmë menagjerin e bankës, i cili na tha që në mëngjes, në orën 8.05, dy persona të maskuar dhe të armatosur ishin futur në bankë. Njëri prej tyre është ndalur pranë hyrjes së bankës dhe i ka detyruar rojet të shtrihen në dysheme dhe ka vajtur në vendin ku mbaheshin të hollat. Janë marrë dy qese të holla dhe pastaj këta u larguan nga banka.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në atë çast, a ju është bërë me dije që menjëherë duhet të kontrolloni të akuzuarin?

B.R. ██████████ Ky incident është i ndërlidhur ne një incident tjetër, i cili ndodhi më 23 shkurt 2008. Burimet i kishin thënë Policisë që grabitja po planifikohej dhe që do të bëhej në degën e Pro Credit Bankës, në Ferizaj.

Na është dhënë emri i Shefit të Sigurimit të Bankës, pra Burim Berisha.

Kryetari i Trupit Gjykses: Më 23 shkurt?

B.R. ██████████ Po. Atëherë jemi ftuar nga Komandanti Rajonal, i cili atëherë ishte Shef i Përgjithshëm i Hetimeve dhe përpiluar një plan operativ. Jam i sigurt që ekziston ende kopja e këtij plani. Ne kemi vëzhguar Rrugën Vllezerit Gervalla, Pro Credit Bankë, Ferizaj për një javë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur një javë? Në shkurt apo në mars?

B.R. [REDACTED] Në shkurt. Kemi vëzhguar një javë. Por, asgjë nuk ka ndodhur. Prandaj, është shtyer plani operativ. Të kthehemi tani te muaji i qershorit. Bazuar në intervistimin tim të menagjerit dhe arkatares, nga e cila janë marrë të hollat, që të dy na thanë që personi i parë i maskuar ndaloj në korridor dhe i dyti shkoi drejt e në zyrën ku po mbaheshin të hollat. Kjo na bëri të mendojmë që është i përfshirë një njeri nga brenda, i cili e njuh terrenin mjaft mirë. Pastaj, zyrtari i sigurimit na tregoi numrat e targave të veturës dhe ne dolëm për ta kërkuar. Disa dolën për të kërkuar veturën ndërsa të tjerët për të kërkuar shtëpinë e Burim Berishës në rrugën 12 Qershori.

Burim Berisha nuk ishte në banesën e tij. Unë nuk isha aty, prandaj nuk mund të them shumë për këtë kontroll. E kontrolluam databazën për të kuptuar se cili është pronari. Kemi kontaktuar njësitë e tjera në stacion sepse një numër i madh i policëve nga Njësia e Vrasjes, Njësia e Krimeve Ekonomike dhe Njësia e Veturave ishin të përfshirë. Prandaj, kemi pasur mjaft kontakte me njëri-tjetrin. Pastaj kemi kuptuar që Burim Berisha do të takohej me persona të tjerë, të cilët kishin grabitur bankën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ju është thënë kjo? Si arritët deri te ky përfundim?

B.R. [REDACTED]: Më herët gjatë kësaj dite, Burim Berisha ishte arrestuar nga patrulla e Kaqanikut. Pra, edhe njësia e Kaqanikut ka qenë e përfshirë. Kemi marrë informata që ai do të takohej me këta persona. Zyrtarët rajonal me rroba civile shkuan në Viti dhe e verifikuan lokacionin. Burim Berisha ishte i ulur vetëm në një tavolinë dhe hetuesit e tjerë ishin të ulur në tavolinën tjetër. Në atë çast, dy persona të tjerë iu bashkuan Burim Berisha, me ç'rast hetuesit brenda ndërtesës së bashku me zyrtarët e tjerë i arrestuan që të gjithë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A i dini emrat e këtyre dy personave të tjerë?

B.R. [REDACTED]: Fikret Murati dhe Fatos Azizi.

Kryetari i Trupit Gjykses: A jeni i sigurt që i treti është Fikret Murati?

B.R. [REDACTED]: Po. Në kafene në Viti.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet emri i kësaj kafeneje?

B.R. [REDACTED]: Jo, nuk më kujtohet. Ka kaluar kohë e gjatë që atëherë. Pas arrestimit të tyre, ne ikëm për të kontrolluar shtëpinë e Fikret Muratit në fshatin Terpeze.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishit i pranishëm gjatë momentit të arrestimit dhe gjatë kontrollit të shtëpisë së Fikret Muratit?

B.R. [REDACTED]: Po. Fikret Murati ishte në veturën e Njesisë Speciale dhe gjatë rrugës, takuam Haki Isufin, i cili ishte së bashku me një person tjetër, më të moshuar. Kolegu im, Toger nga Njësia Ekonomike kishte më shumë kontakte me Majorin, i cili ishte në detyrë me Njësinë dhe mori informatën që edhe Haki Isufi duhet të arrestohet.

Ne u ndalëm dhe pyetëm se ku është shtëpia e Haki Isufit. E pyetëm vetë Haki Isufin. Ai tha që janë dy persona me emrin Haki Isufi dhe "nuk e di se cilin prej tyre e kërkoni." Pasi që ecëm edhe 5 apo 6 metra, kolegu im u ndal dhe më tha: 'Eja t'i kërkojmë letërnjoftimin,' dhe kur ia kërkua këtë e vërejtëm që ishte mu ai.

Kur e pyetëm 'ku është shtëpia juaj?' ai na tregoi një shtëpi aty afër. Në këtë shtëpi Njësia e Kontrollit po bënte kontroll dhe aty ishte vetëm një njeri dhe shtëpia ishte pronë e një njeriu që jeton në Zvicër.

Pastaj u kthyem dhe Hakiu na dërgoi në shtëpinë e tij. Njësia Speciale e Hetimeve kontrolloi shtëpinë e Haki Isufit dhe derisa po e kontrollonim atë, unë isha në garazhin, pronë e të vëllait të tij. Me sa më kujtohet, por nuk jam plotësisht i sigurt, Majori i Njesisë Speciale erdhi dhe më tha 'eja të shkojmë. I zbuluam të hollat'. Pastaj i morëm veturat dhe vozitëm te shtëpia e Fikret Muratit. Kontrolluam shtëpinë aty. Ç'është e vërteta, unë qëndrova jashtë së bashku me një koleg tjetër sepse ishin 4 vetura të policisë.

Ky vend ishte i rrethuar me bjeshkë. Prandaj, unë ruaja veturat dhe sigurohesha që askush të mos i afrohej shtëpisë. Pastaj erdhën kolegët dhe thanë që të hollat nuk ishin në tavan. Unë nuk isha i pranishëm. Por, u bënë disa telefonata dhe Fikreti bisedoi me dikë. Por, sidoqoftë, unë nuk mund të them më shumë ngase nuk isha i pranishëm dhe një ndër motrat e Fikretit doli jashtë dhe shkoi poshtë rrugës dhe kishte me vete një qese, e cila ishte përplot me të holla.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e keni parë ju këtë qese përplot me të holla?

B.R. [REDACTED]: Po. Në mënyrë që të siguroheshim se çfarë kishte në qese, njëri nga Njësia hapi qesen dhe pa që ishte përplot me të holla. E mbyllëm atë dhe e vendosëm në veturën e Majorit dhe e kthyem në Ferizaj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Shkoni edhe një hap më tutje. Në çastin që morët informatat nga menagjeri i bankës dhe nga arkatarja e bankës, a ju kujtohen emrat e tyre?

B.R. [REDACTED]: Më vjen keq, nuk më kujtohen. Por, i kam të shënuar në kallëzimin penal.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë ju thanë ata me saktësi?

- B-R [REDACTED]: Ju thashë më herët që mbajta një intervistë gojore. Atëherë këta ishin shumë të stresuar dhe të frikësuar. Por, i përshkruan me maska të zeza dhe me armë në dorë. Kur hynë në bankë, njëri prej tyre i detyroi rojet e sigurimit të shtrihen në dyshe me dhe i dyti shkoi në zyrën e arkatares, aty ku mbahen të hollat. Mund ta shihni fare qartë në xhirim që i gjithë incidenti zgjati më pak se një minut e gjysmë, gjë e cila na bëri të kuptojmë që një njeri i cili e njuh këtë bankë fare mirë është i përfshirë sepse edhe mua, duke qenë hetues, më është dashur pak kohë që ta gjej zyrën e arkatares.
- Kryetari i Trupit Gjykses: A ju dha menagjeri ndonjë indikacion lidhur me këta dy individë që hynë në bankë në mënyrë që ju t'i identifikoni ata?
- B-R [REDACTED]: Jo, këta po mbanin maska. Prandaj, nuk ka qenë e mundur që të identifikoheshin.
- B-R [REDACTED]: Kryetari i Trupit Gjykses: A ju dhanë ndonjë informatë lidhur me rrobat e tyre?
- B-R [REDACTED]: Ne kemi marrë shënime, por këta janë marrë nga teknikët e forenzikës, të cilët menjëherë filluan punën e tyre, pra lidhur me gjurmët dhe përshkrimet.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Pas arrestimit të Burim Berishës dhe personit të dytë dhe pastaj atij të tretit, a është sjellë ky në bankë për të parë rrobat e tij?
- B-R [REDACTED]: Jo.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, është sjellë në stacionin e policisë në Ferizaj?
- B-R [REDACTED]: Po. Më duhet të theksoj që shtëpia e Fikret Muratit, ajo e Haki Isufit si dhe shtëpia e Xhelal Azizit, i cili është i arratisur, janë kontrolluar dhe e gjithë kjo zgjati nga ora 10:30 deri në 23:00. Vetëm një raport kemi përpiluar atë natë. E kemi marrë në pyetje Fikret Muratin dhe të tjerët kanë refuzuar të japin deklaratë.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, Fikret Murati ka qenë i vetmi që ka dhënë deklaratë?
- B-R [REDACTED]: Po. Atij iu është mundësuar prania e një avokati dhe të hollat janë numëruar para avokatit të tij.
- Kryetari i Trupit Gjykses: E lidhur me Xhelal Abazin?
- B-R [REDACTED]: Xhelal Azizin.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Si keni ardhur deri te përfundimi që ky ka qenë i përfshirë?
- B-R [REDACTED]: Derisa kanë qenë në Terpez, sigurisht që dikush nga policia ka biseduar me Fikretin dhe Hakiun. Prandaj, menjëherë pas kontrollit të shtëpive të këtyre dyve, ne kemi shkuar drejt e në shtëpinë e Xhelal Azizit për ta kontrolluar. Nuk e di si janë marrë informatat, por unë kam qenë i pranishëm gjatë kontrollit dhe Xhelali nuk ka qenë i pranishëm. Mendoj që gruaja dhe motra e tij kanë qenë aty. Kur i pyetëm 'kur ka shkuar,' ato thanë 'herët në mëngjes dhe nuk është kthyer më.'
- Kryetari i Trupit Gjykses: Para se të ndodhin këto gjëra, a i keni njohur ju të akuzuarit, jo si shokë, por a keni pasur dijeni mbi ta?
- B-R [REDACTED]: Jo, nuk e kam njohur asnjërin prej tyre. Më parë ju thashë që kemi marrë informata lidhur me Burim Berishën në shkurt, por jo deri në çastin e arrestimit të tij.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Në këto informata lidhur me Burim Berishën në shkurt, a është përmendur edhe dikush tjetër?
- B-R [REDACTED]: Po, është folur edhe për persona të tjerë. Mendoj që kanë qenë nga Maqedonia. Por ne i kishin vetëm emrat e tyre e jo edhe mbiemrat apo detale të tjera të sakta siç kishim për Burim Berishën.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, ju veç kishit identifikuar Burim Berishën?
- B-R [REDACTED]: Kishim informata për të. Por, unë nuk e kisha njohur më parë.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka qenë udhëheqës i këtyre hetimeve atëherë? Kush i ka dhënë udhëzimet?
- B-R [REDACTED]: Komandanti Rajonal dhe Shefi i Operativës Isa Hyseni. Atëherë, operacioni është udhëhequr nga Majori i Njësisë Operative, Rashit Qalaj. Ai ishte përgjegjës për Njësinë Speciale. Ai ishte më i përqëndruar aty si dhe Togerit që po zëvendësonte Togerin e Përgjithshëm Hetues, ai quhct Shaib Gashi, Shef i Njësisë së Forenzikës.
- Kryetari i Trupit Gjykses: A ka njohuri dëshmitari mbi mënyrën sesi është gjetur revolveri në Restorantin Buka Petrol?
- B-R [REDACTED]: Po. Me sa më kujtohet, ishte 11 korriku dhe Burim Berisha ishte në paraburgim në Këqanik. Shefi i Njësisë së Hetimeve udhëzoi Rreshterin Seladin Shahini dhe mua që të marrim në pyetje Burim Berishën lidhur me incidentin.
- Derisa ishim aty, pritëm pak derisa erdhi edhe avokati i këtij të fundit. Uën nuk isha i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse edhe dy hetues të tjerë po mermin në pyetje pronarin e Opel Vektrës në zyrën tjetër.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Jo, të përqëndrohemi te Burim Berisha.

B.R. [REDACTED] Pra, kam lëvizur shumë nga një zyre në tjetrën. Burim Berisha kundërshtonte pretendimet që ky ishte futur në bankë por pranoi që kishte hedhur armën në shportën e mbeturinave në Buca Petrol.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A e pranoi këtë gjë në praninë e avokatit të tij?

B.R. [REDACTED] Jo, e pranoi derisa po e pritnim avokatin.

Ky rikonstruksion i hetimeve është gjithashtu koherent me atë të siguruar nga Komandanti Rajonal në Ferizaj, Isa Hyseni dhe oficeri i policisë nga njësia e forensikës Sadush Rahmani që nuk përmendet në këtë aktgjykim me qëllim të mospërsëritjes.

DVD-të që përmbajnë regjistrimet video të ngjarjes të regjistruara nga kamerat e sigurisë të vendosura jashtë dhe brenda lokaleve të filialit Pro Credit Bank në Ferizaj janë lëshuar dhe parë gjatë shqyrtimit kryesor. Videoja tregon se grabitja e bankës është bërë me datën 9 qershor, 2008, dhe zgjat 1 minute e gjysëm, saktësisht nga ora 08:06:07 deri në orën 08:07:47, nga koha e hyrjes e kryerësit të parë deri tek dalja e kryerësit të fundit. Një makinë Golf e gjelbër është afruar bankës dhe është parkuar menjëherë përballë hyrjes. Shpejt pas kësaj, kryerësi i parë, me roba të zeza, ka dalë nga makina dhe ka hyrë në bankë, ndërsa ishte i maskuar, me dorëza të verdha dhe mbante një armë. Personi është pozicionuar menjëherë brenda hyrjes së bankës, duke paralajmëruar gjithë të pranishmit që të mos lëviznin dhe duke drejtuar një armë në drejtim të tyre. Pastaj personi i dytë, me një xhempër të kuq, edhe ai me dorëza të verdha dhe me armë, ka hyrë dhe ka shkuar drejt tek zyra ku gjendeshin paratë, ka marrë dy çanta që mbanin paratë dhe ka dalë nga banka. Në fund, edhe personi i parë ka dalë nga banka dhe ata me shpejtësi janë larguar me makinë nga vendngjarja.

Duhet të vërehet se personi i dytë që ka hyrë në bankë ka shkur drejt tek zyra ku gjendeshin paratë dhe ka treguar se kishte një orientim të plotë brenda lokaleve të bankës, të cilin mund ta kishte vetëm një person nga brenda që kishte punuar aty më parë. Kryerësi as nuk ka pasur nevojë të shikojë përreth qoftë edhe një sekond kur ka hyrë në bankë por vetëm ka vazhduar në drejtim të zyrës ku gjendeshin paratë. Dhe në fakt, Burim Berisha kishte punuar në këto lokale si Mbikqyrës Sigurimi, gjë që i ka dhënë atij mundësinë të njihej me vendndodhjen e saktë të zyrave dhe parave. Duhet të nënvizohet edhe një herë fakti se e gjithë grabitja, nga momenti i hyrjes së kryerësit të parë në bankë deri tek dalja nga banka e kryerësit të dytë, janë dashur vetëm 1 minutë e gjysëm, saktësisht nga ora 08:06:07 deri në orën 08:07:47, duke qenë kështu një veprim jashtëzakonisht i shpejtë.

Makina Alfa Romeo, ngjyrë e kuqe, pronë e Burim Berishës, është kontrolluar më vonë nga policia dhe poshtë pedaleve të ulëses së shoferit janë gjetur 15 plumba të mbuluar me një mbulesë metali, siç tregohet në fotografitë 57 – 70 në raportin e policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008.

Golfi II, ngjyrë e gjelbër, 202-KS-943, pronë e Selami Beqirit, i përdorur për grabitjen e bankës është gjetur gjithashtu, siç tregohet në fotografitë 71-71 të raportit të policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008. Për më tepër, dorëzat e verdha dhe maska e zezë me vrima janë gjetur brenda makinës Golf II, pronë e Selami Beqirit siç tregohet në

fotografitë 87-108 të raportit të policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008. Ditën e ngjarjes, Selami Beqiri ka shkuar në stacionin e policisë për të njoftuar se makina e tij ishte vjedhur. Në të vërtetë, siç do të ilustrimet më vonë, Selami Beqiri kishte siguruar ndihmë kryerësve të grabitjes duke iu siguruar makinën e tij me qëllim kryerjen e grabitjes.

Pala tjetër e dorëzave të verdha është gjetur më vonë, siç tregohet në fotografitë 109-120 në raportin e policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008.

Siç është përmendur më parë, pistoleta që është përdorur nga Burim Berisha për grabitjen e bankës është gjetur më vonë nga hetuesit në koshin e plehrave që gjendet në restorantin "Buca Petrol" siç tregohet në fotografitë 121-135 në raportin e policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008. Bëhet fjalë për një Pistoletë VZOR 50 prodhim Çek, nr 30238, me tre plumba të kalibrit 7.65x17mm, siç raportohet në raportin e policisë së forensikës 2008-1141 i datës 25 gusht 2008. Është e rëndësishme të shënohet se Burim Berisha ka qenë i pranishëm në restorant ditën e ngjarjes, me datë 9 qershor 2008, përafërsisht mes orës 08:00 dhe 09:00, sipas dëshmisë së kamarierit [redacted]. Më tej dëshmitari ka deklaruar në gjykatë se Burim Berisha ka arritur atë ditë me taksì, i veshur me rroba sportive dhe me patika. I pandehuri i ka kërkuar [redacted] të përdorë telefonin e tij mobil, duke thënë se telefoni i tij personal nuk kishte kredi. Burim Berisha ka qëndruar atje për rreth një orë deri kur ai është arrestuar nga policia. Koha e pranisë së tij në restorant është pra në përputhje me përfshirjen e tij në grabitje, sepse grabitja kishte përfunduar në orën 08:07:47 dhe ai kishte kohë të mjaftueshme për të arritur në "Buca Petrol" rreth orës 08:30.

Në vijim janë të raportuara pjesët relevante nga ekzaminimi i dëshmitarit [redacted] Q. 7

- Prokurori Publik: Çfarë pune keni bërë gjatë muajit të qershorit vitin e kaluar?
Q. 7 [redacted] Si kamarier në restorantin "Buca Petrol" dhe prapë punoj aty.
Prokurori Publik: Cili ka qenë orari i punës?
Q. 7 [redacted] Nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 3:30 të pasdites.
Prokurori Publik: A e njihni të akuzuarin Burim Berisha?
Q. 7 [redacted] Po.
Prokurori Publik: A ju kujtohet nëse Burim Berisha, ka ardhur në "Buca Petrol" me datë 9 qershor 2008?
Q. 7 [redacted] Ka qenë ora rreth 8, 8:30 apo 9 e mëngjesit.
Prokurori Publik: Si ka ardhur atje?
Q. 7 [redacted] Me sa më kujtohet ka ardhur me taksì.
Prokurori Publik: A ka hyrë menjëherë në restorant?
Q. 7 [redacted] E di se ka hyrë në restorant por nuk e di se kur.
Prokurori Publik: Ku është ulur në restorant?
Q. 7 [redacted] Në tavolinën ku klientët pinë kafe.
Prokurori Publik: A ka qenë vetëm apo me dikë tjetër?
Q. 7 [redacted] Vetëm.
Prokurori Publik: Ai ishte i ulur vetëm por a ka folur me punëtorët e restorantit?
Q. 7 [redacted] Ishte personeli i kuzhinës, me emrin Jeton.
Prokurori Publik: A ke folur me të?
Q. 7 [redacted] Po.
Prokurori Publik: A ka qenë sjellja e Burimit si zakonisht apo ka qenë ndryshe?
Q. 7 [redacted] Ishte normale si zakonisht.

- Q-2 Prokurori Publik: A ka bërë ndonjë telefonatë në atë kohë?
 [Redacted] Po, ka përdorur telefonin tim.
- Q-2 Prokurori Publik: A ju kërkuar telefonin tuaj dhe pse?
 [Redacted] Ai e kërkoi por nuk e di se pse?
- Q-2 Prokurori Publik: Sa telefonata ka bërë?
 [Redacted] Me sa më kujtohet ka bërë vetëm një telefonatë nga telefoni im.
- Q-2 Prokurori Publik: Sa kohë ka qëndruar në restorant?
 [Redacted] Rreth një orë, nuk e di me saktësi sepse isha duke punuar.
- Q-2 Prokurori Publik: A keni qenë në gjendje të dini nëse ai ka pasur armë?
 [Redacted] Jo
- Q-2 Prokurori Publik: Gjatë kësaj kohe, a është ngritur?
 [Redacted] Nuk e di.
- Q-2 Prokurori Publik: Çfarë ka ndodhur pastaj, a është larguar vetëm?
 [Redacted] Jo, një oficer i policisë ka ardhur dhe e ka marrë... (mungon)..
- Q-2 Avni Ibrahim: A ju kujtohet se çfarë ka pasur veshur atë ditë?
 [Redacted] Me sa më kujtohet ai ishte veshur me rroba sportive dhe patika.
- Q-2 Avni Ibrahim: A ju kujtohet ngjyra?
 [Redacted] Nuk jam i sigurtë për ngjyrën. Ka kaluar kohë. (mungon)
- Q-2 Andrea Cruciani: Ndoshta e keni përmendur por duhet të ju pyes. Kur ai ju ka kërkuar telefonin, a e keni pyetur pse apo ai ishte shok i ngushtë dhe ju nuk e keni pyetur kurrë pse?
 [Redacted] Ai kërkoi të përdorte telefonin tim sepse tha se nuk kishte kredi në telefonin e tij.

Për më tepër, gjatë kontrollit në shtëpinë e xhaxhait të Fikret Muratit janë gjetur edhe paratë e grabitura në bankë, në një çantë sporti, ngjyrë qershi, siç tregohet në fotografitë 75-84 në raportin e policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008. Dy çantat ngjyrë kafe të grabitura në bankë janë gjetur të boshatisura në pyll siç tregohet në fotografitë 144-151 në raportin e policisë së forensikës VN#46-08 i datës 9 qershor 2008. Gjatë ekzaminimit të tij, i akuzuari nuk ka qenë në gjendje të sigurojë një justifikim në lidhje me provat fajësuese, as nuk ka mundur të paraqesë një alibi. Në vijim të një fragment nga procesverbali i ekzaminimit të të pandehurit.

Prokurori Publik: Ju keni punuar në ProCredit Bank?
 Burim Berisha: Po.

Prokurori Publik: Çfarë keni bërë atje?

Burim Berisha: Detyra ime në bankë ka qenë puna si mbikqyrës sigurie për rajonin e Ferizajt, që do të thotë filialet në Shtime dhe tre filialet tjera në Ferizaj, një në Kacanik dhe një në Hanin e Elezit.

Prokurori Publik: A i keni njohur më parë të akuzuarit e tjerë?

Burim Berisha: Përveç Fatos Azizit dhe Haki Isufit, të tjerët nuk i kam njohur.

Prokurori Publik: Si e keni njohur Haki Isufin?

Burim Berisha: Jam njohur me Haki Isufin para një viti sepse ai ishte i interesuar të gjejë një punë në të njëjtën kompani ku punoja unë dhe kjo ka qenë aryeja e njohjes së tij.

Prokurori Publik: A mund të na thoni për personin e dytë që keni njohur?

Burim Berisha: Fatos Azizi. E kam njohur përmes kolegut tjetër që punon në Viti. E kam takuar dhe qëllimi i njohjes ka qenë i njëjti, për të gjetur një punë.

Prokurori Publik: A njihni Fikret Muratin?

Burim Berisha: Jo.

Prokurori Publik: Ju thatë se keni njohur Fatos Azizit dhe Fikret Muratin në lidhje me punësimin, për çfarë lloj pune?

Burim Berisha: Për të gjetur një punë në të njëjtën kompani ku punoja unë.

.....(mungon).....

Prokurori Publik: A ju kujtohet data 9 qershor 2008? A ka qenë ditë pushim apo ju duhej të punonit atë ditë?

Burim Berisha: E kam pasur ditë pushim.

Prokurori Publik: Çfarë keni bërë atë ditë?

Burim Berisha: Jam zgjuar herët, sikur të kishte qenë ditë pune, përpara orës 7 të mëngjesit.

Prokurori Publik: Ku keni shkuar?

Burim Berisha: Atë ditë, kam shkuar përpara apartamentit tim, kam marrë një taksi dhe kam shkuar në kafeterinë Buca Petrol dhe qëllimi i shkuarjes atje ka qenë për të takuar dy të afërm të mij sepse javën më parë kishte dalur një lajmërim për të marrë punëtorë të rinj dhe i kam informuar se ata kishin mundësinë të aplikonin për punë dhe se mund të ishin me fat.

Prokurori Publik: Kë këni informuar?

Burim Berisha: Kam informuar Avni berishën dhe Ahmet Berishën.

Prokurori Publik: Sa kohë këni qëndruar, kur keni shkuar atje dhe kur jeni larguar?

Burim Berisha: Nuk më kujtohet koha e saktë sepse ka kaluar rreth një vit. Ka qenë rreth orës 8.

Prokurori Publik: Ju keni shkuar atje në atë kohë?

Burim Berisha: Po. Rreth orës 8.

Prokurori Publik: A keni qenë i shoqëruar nga dikush?

Burim Berisha: Jam ulur vetëm në tavolinë. Pronarin e restorantit Buca Petrol e kam njohur më parë sepse kemi punuar bashkë në një restorant nga viti 2000 deri në vitin 2005 që gjendet në rrugën Ferizaj-Kacanik dhe quhet Europa 92.

Prokurori Publik: Si quhet ai?

Burim Berisha: Qerim Jaha. Nuk jemi ulur bashkë sepse ai ishte duke punuar dhe duke shërbyer klientë të tjerë.

Prokurori Publik: A keni folur me dikë në telefon?

Burim Berisha: Po.

Prokurori Publik: Me telefonin e kujt? *Q. J.*

Burim Berisha: Kam përdorur telefonin e [redacted] Kam thirrur bashkëshorten time dhe i kam thënë se më duhej të shkoja në Prishtinë.

Nje pjese tjeter relevante e nje prove shfajesuese eshte bere me anen e rezultateve te matjes se thirrjeve telefonike, te cilat kane vertetuar se Burim BERISHA ka kontaktuar Haki ISUFIN ne pasdrecken dhe mbremjen para dites kritike dhe ne te njejten dite te 9 qershorit 2008:

Me 09.06.2008 ne oren 15.15.47 nga 44746 [redacted] ka thirre Haki ISUFIN ne numrin 4434 [redacted]

Me 08.06.2008 ne oren 14.53.22 nga 049659 [redacted] eshte derguar nje SMS Haki Isufit ne numrin 864944 [redacted]

Me 08.06.2008 ne oren 20.25.44 nga 049659 [redacted] eshte derguar nje SMS Haki Isufit ne numrin 37744346 [redacted]

Me 09.06.2008 ne oren 19.08.39 nga 049659 [redacted] eshte thirre Fikret Murati ne numrin 38649443 [redacted]

Me 09.06.2008 ne oren 19.18.35 nga 049 659 [redacted] eshte thirre Haki Isufi ne numrin 38649443 [redacted]

Me 08.06.2008 ne oren 15.29.14 nga 049659 [redacted] eshte derguar nje SMS Haki Isufit ne numrin 38649443 [redacted]

Me 08.06.2008 ne oren 20.58.43 nga 049659 [redacted] eshte derguar nje SMS Haki Isufit ne numrin 38649443 [redacted]

Lidhur me kete Burim BERISHA ka pohuar gjate egzaminimit se ai e njihte Haki ISUFIN sepse ky i fundit ishte i interesuar per te gjetur pune ne te njejten kompani ne te cilen Burim BERISHA kishte punuar. Kjo poashtu mund te jete e vertete. Megjithate, eshte interesant te konstatohet se kontaktet ne mes Burim BERISHES dhe Haki ISUFIT ishin nderpre plotesisht gjate mengjesit te 9 qershorit 2008. Ne te vertete, Burim BERISHA kishte qene jashtezakonisht i kujdesshem ne kufizimin maksimal te kontakteve telefonike me te pandehurit tjere. Poashtu ne "Busa Petrol" ai kerkoj te shfrytezonte telefonin e kamariert per te mos e perdorur ate te vetin.

Me rendesisht, involvimi i te pandehurit Burim BERISHA ne grabitjen e bankes eshte vertetuar ne menyre t qarte me deklaratat e te bashke-akuzuarit Fikret MURATI, i cili ka

ofruar informata te hollesishme lidhur me tere ngjarje en grabitjes se bankes. Me rendesi vendimtare per rastin e tashem jane deklaratat te cilat ia ka dhene policise i pandehuri Fikret MURATI me 10 qershor 2008, derisa ishte i asistuar nga avokati i tij Nexhat QORROLLI, dhe te cilat do te konsiderohen si deshmi te pranueshme ne pajtim me Nenin 156 dhe 157 te KPPK-se.

“Une, Fikret MURATI deklaroj se te merkuren jam takuar me Hakiun ne fshatin Terpeze dhe ai me tha: “Nese mundesh me e gjete dikend qe mundet me hy ne Banke per te marre te holla, dhe per kete do te shperblehesh nese e gjen dikend”. Une i thash se une vete kete gje nuk mundem me e be, por do te mundohem me e gjete dikend tjeter per kete. Pas 1 apo 2 diteve une dhe Hakiu erdhem ne Ferizaj me “Rover”-in e Hakiut. Hakiu ka biseduar me Burimin dhe une u involvova ne bisede pas 10 minutave, dhe hakiu me se “Nese e gjene personin ai (Burimi) eshte i gatshem te drejtoje operacionin ne banke te henen”. Pas shkuarjes ne shtepi, e takova fshatarin (fqium) tim Xhelalin dhe e pyeta: “A mendon se mundesh me hy ne banke per te marre te holla nga ajo, dhe Xhelali me tha “une do te hyj”. Te shtunen, une dhe Xhelali erdhem ne Ferizaj ne nje kafe-bar ne rrugen e Gjilanit ku u takuam me Burimin. Aty, Burimi, gjate bisedes me Xhelalin, ne mes tjerash, i tha: “nese me tradheton, me mire eshte te mos hysh fare, sepse ti do te jesh i pari te cilin do ta vraj, e pastaj te tjeret, sepse une nuk do t’i dorezohem policise i gjalle pa i shpenzua te gjithë plumbat qe i kam”. Xhelali i tha: “Une nuk te tradhetoj”. Atehere Burimi i tha Xhelalit se: “ti do te qendrosh prane deres se bankes, derisa une, une do t’i marre te hollat nga arka, sepse une di saktesisht se ku ajo eshte”. Aty Xhelali dhe Burimi e caktuan kohen per t’u takuar te henen ne oren 07.30 ne banesen e Burimit ne ferizaj. Te henen, me 09.06.2008 une erdha ne ferizaj me Mercedesin tim kurse Xhelali erdhi me Golfin e selamiut dhe u takuam me Burimin ne banesen e tij. Une menjehere u ktheva ne shtepi dhe i lash ata ne banesen e Burimit.”

Ne oren 08.15 Burimi me thirri ne telefon dhe me tha: “A po vjen me me marre te Kisha Katolike ne Ferizaj?”, dhe une i thash: “Jo, nuk do te vij”.

Rreth ores 12:15 dikush me thirri ne telefonin tim dhe me tha: “Shko te koder, sepse Xhelali do te vije tash dhe ai do t’i sjell te hollat”. Une shkova te kodra e cila eshte afer shtepise sime, aty ishte Xhelali me me nje cante sportive te ngjyres se vishnjes se mbyllte, pas nje kohe arriti Hakiu, Xhelali e ka hapur canten dhe ne te trete i kemi pare te hollat, dhe hakiu tha se askush nuk guxon me i preke te hollat derisa te vjen Burimi ketu, perndryshe ai qe i preke do te vritet”. Une e mora canten dhe e solla te shtepia e xhamait. (vellau i babes tim) dhe e lash ne tavan (hapesira nen kulm) dhe dola jashte ne fshat. Burimi me thirri ne telefon dhe me tha: “Ku do te takohemi?” mirepo Hakiu me kishte thene me heret: “Une do te mbylli telefonin tim, dhe nese Burimi therret thuaj se do te takohemi ne kafe-barin perballe xhamise ne Viti”. Dhe une i thash Burimit qe te takohemi atje. Une shkova ne vendin e caktuar, e takova Burimin dhe Fatosin aty dhe qe te trete jemi arrestuar ne te njejten kafe-bar nga ana e policise.

Pyetje dhe pergjigje:

- Si i ke njohte Burimin, Fatosin, Hakiun, Selamiun dhe Xhelalin?
- Hakiu dhe Xhelali jane bashkefshataret e mi (ne jetojme ne te njeitin fshat), Hakiu me ka njoftua me Burimin para 4 apo 5 diteve, dhe Fatosi eshte dhenderri (burri i motres) i Hakiut dhe me te jam njoftuar para 3 diteve, dhe une e njoh Selamiun sepse ai eshte i martuar me nje kusherire te nenes sime.
- Sa ishte shuma e te hollave qe Hakiu te kishte premtuar me t’i dhene nese e gjene personin per te hyre ne banke?

- Ai nuk e ka percaktuar nje cmim, por ka thene se une do te mirrja nje shperblim.
- Me kend eshte marre vesh Selamiu me ia dhene veturen grabitesve te bankes?
- Hakiu me ka thene qe te thirrja Selamiun me telefonin tim, te shkoja ne Terpeze dhe qe te arrija nje marreveshje lidhur me veturen.
- A ishe i pranishem atehere kur arriti Selamiu aty dhe cka eshte diskutuar aty?
- Selamiu ka ardhne ne Terpeze te dielen, kurse une, Hakiu dhe selamiu jemi takuar ne fshat, atje ata dy u pajtuan qe Selamiu do te linte veturen ne oborrin e shtepise pa e mbyll me qeles dhe poashtu do t'i linte qelesat ne veture per Xhelalin qe te vinte dhe te mirrte veturen ne mengjes. Dhe keshtu eshte vendosur qe selamiu te linte veturen sipas marreveshjes.
- A eshte diskutue aty me Selamiun se cfare do behej lidhur me veture?
- Po. Hakiu i tha Selamiut: "Rreth ores 09.30 shko ne polici dhe lajmeroji se vetura e jote eshte vjedhur", dhe Selamiu pranoi.
- Deri ne c'mase eshte Fatosi i involvuar ne kete rast?
- Aq sa di une, Fatosi e ka gjete personin detyra e te cilit ishte qe t'i largonte ata nga Ferizaji dhe per kete ai do te mirrte 10000 Euro, dhe nga kjo shume e te hollave Fatosi eshte dashur te paguante personin me veturen Vectra.
- A din se nga vjen ky personi me veturen Vectra?
- Aq sa di une, ai ishte nga fshati Kabash, Viti, por une nuk ia di emrin.
- Kush ka hyre brenda ne banke per t'i marre te hollat?
- Xhelali dhe Burimi kane hyre ne banke.
- A je i sigurt per ate qe po e thua?
- Jam plotesisht i sigurt per kete.
- A keni dic tjeter per te shtuar ne kete deklarate?
- Jo, nuk kam.

Te gjitha elementet e permendura vertetojne pertej cdo dyshimi te arsyeshem involvimin e Burim BERISHES ne grabitjen e bankes, pergjegjesi kryesor i kryerjes se kesaj vepre. I pandehuri ka kryer nje veper kriminele, e cila me te drejte do te kualifikohet si grabitje, ne kundershtrim me nenin 255 (1)-(3) te KPK-se, duke i permbushur elementi material (actus rei) dhe elementin psikologjik (dolus) te nje krimi te tille. Ai ka qene ai qe ka siguruar instrukcionet te gjithe te pandehuerave tjere dhe se, ai se bashku me Xhelal AZIZIN kane hyre ne banke duke mbajtur armen ne dore per t'i marre te hollat nga banka. Ai e ka shfrytezuar poziten e tij te privilegjuar si mbikqyres i rojtareve te sigurimit te bankes, tere informatat konfidenciale qe i jane besuar dhe ka keqperdore poziten e tij per aktivitete kriminale me qellim te perfitimit material per veti.

2.2. Posedimi i paautorizuar i armeve, ne kundershtrim me Nenin 328 (2) te KPK-se.

Siq eshte demonstruar ne paragrafin e meparshem, te Burim BERISHA jane gjete pesembedhete (15) plumba te cilet jane zbuluar Brenda ne Alfa Romeon e tij te kuqe qe ishin te nje arme qe eshte perdore per grabitjen e bankes, e cila eshte gjetur ne koshin e plherave te restoranit te "Busa Petrol", aty ku eshte arrestua.

Arsyetimi qe ka ofruar I pandehuri gjate marrjes ne pyetje ne gjykimin kryesor qartazi nuk jane ne gjendje te lirojne ate nga akuza, pasi qe posedimi i armeve dhe te municionit eshte nje fakt i cili eshte vertetuar me raportet e policise te cilet i kane bere bastisjet ne veturen dhe restoranin e lartepmendur:

Prokurori Publik: A erdhi dikush nga policia?

Burim Berisha: Pas nja 10 minutave ka ardhë një patrollë e policisë dhe me treguan se ishte lëshuar urdheri për arrest dhe se ata ishin autorizuar menjëherë nga e njëjta komune nga e cila jam edhe unë, ata me thanë unë duhej të shkoja me ta në stacionin e policisë në Ferizaj.

Prokurori Publik: A shkove ti me ta?

Burim Berisha: derisa udhëtonim nga Busa Petrol për në qytet ata moren një urdher prej një njesiti të SHPK-se që menjëherë të shkojnë dhe të bëjnë bastisjen e shtëpisë dhe të veturës së tij.

Prokurori Publik: Ata flisnin lidhur me ty?

Burim Berisha: Po, flisnin. Në pastaj shkuam ke vetura.

Prokurori Publik: Në cilën veturë?

Burim Berisha: Në Alfa Romeon e kuqe. Gjate bastisjes ata i gjetën 15 plumba të cilat i permenda në zyrën e Prokurorit Publik, janë të një të afërmi tim i cili quhet Bajram Zeneli i cili është marrë shumë me armë.

Prokurori Publik: Si e gjetën veturën tendë?

Burim Berisha: Ata kanë ardhë të vetura ime dy os tri javë më parë sepse ky i afërmi im kishte ardhë njëherë në Ferizaj për më shite ca plumba dhe nuk di se çfarë ka ndodhur me plumbat që nuk i kishte shite dhe ai më pat lute që t'i mbaja ata për të një apo dy dite. Unë i kam treguar se nuk do të lejoja që t'i sillte ata në banesën time por mund ta mundesoj më i lenë ata në veturën time pasi që vetura nuk përdorej që nga momenti që ishte prish për afërsisht një muaj më heret.

.....(omissis).....

Prokurori Publik: Një armë është gjetur në koshin e plehrave brenda në Buca Petrol. Është e prodhimit Cek, a është e jotja?

Burim Berisha: Nuk është e imja.

Kështu pra, elementi material (*actus rei*) është vertetuar me anën e rrethanave faktike se pistoletat e përdorur gjatë grabitjes dhe pesëmbëdhjetë (15) plumbat që ishin gjetur në koshin e plehrave në restorantin "Busa Petrol" dhe në veturën e tij Alfa Romeo e kuqe, pas një aktivitetit të bastisjes dhe të konfiskimit të ligjshëm nga ana e policisë.

Elementi psikologjik (*mens rea*) është vertetuar në baze të njohurisë që të mbaje materialin e përmendur pa leje valide.

Sa i përket kualifikimit ligjor të veprës kriminale, më të drejtë është referimi i tij në Nenin 328, paragrafi (2) të KPK-se i cili kriminalizon "Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose Shfrytëzim të Paautorizuar të Armeve".

Sendet e gjetura me siguri duhet të klasifikohen si armë. Në të vertete, sipas nenit 107, paragrafi 28 të KPK-se, shprehja "armë" do të thotë një mjet I prodhuar që përdoret ose është I përshtatshëm të përdoret për të shkakuar lëndime trupore. Në mes tjerash, përfshin të gjitha llojet e municionit, shigjetat automatike, harqet, shigjetat, sprejin, gazin lotsjelles, armët me qorrfishëke, armët imituuese, armët alivanosese, taseret (mjetet që punojnë në baze të elektrohokut) dhe të gjitha kategoritë e armëve të paraqitura në Tabelën A të bashkangjitur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armeve në Kosovë ose me armë të ngjajshme".

3. Përgjegjësia kriminale e Haki ISUFIT.

Nga provat e tubuara gjatë gjykimit del se involvimi i Haki ISUFIT në grabitjen e bankës përbehej nga aktiviteti kryesor i mbështetjes së aksioneve të Burim BERISHES dhe të Xhelal AZIZIT. Vecanerisht, Haki ISUFI e ka pyet Fikret MURATIN që të gjeje

nje person tjetër me te cilin Burim BERISHA do te grabiste banken dhe Burim BERISHES do t'i ofronte tere mbeshetjen e duhur pas realizimit te grabitjes se bankes per t'i siguruar te hollat. Ne te vertete, Haki ISUFI poashtu kishte shkuar ne shtepine e xhaxhait te Fikret MURATIT per te kontrolluar se a mbahej canta me te holla ne menyre te sigurt aty. Vec kesaj ai e ka kontaktuar dhenderrin e tij Selami BEQIRIN qe te siguroje veturen qe eshte perdore gjate grabitjes se bankes.

Gjate marrjes ne pyetje te te pandehurit Haki ISUFI ai i ka mohuar te gjitha akuzat kunder tij. Keto jane fragmentet interesante te proqesverbalit te marrjes se tij ne pyetje:

Prokurori Publik: Ne ditën kur ndodhi rasti dhe për të cilin jemi sot këtu, a mund të na tregoni se cka ka ndodhur në atë ditë?

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Në mëngjes.

Prokurori Publik: Po.

Haki Isufi: Me 9 qershor, jam zgjuar në orën 07.45 ose 07.50 dhe si zakonisht kam pirë një kafe. Kam qëndruar në shtëpi deri në orën 11.00 ose 11.15 dhe pastaj kam shkuar në Viti.

Prokurori Publik: Me çfarë mjeti?

Haki Isufi: Me veturë.

Prokurori Publik: Nga cili fshat jeni?

Haki Isufi: Fshati Terpeze.

Prokurori Publik: Sa zgjatë rruga për të shkuar nga Terpeza në Viti?

Haki Isufi: 15, 20 ose 25 minuta, varesisht se si vozitni.

Prokurori Publik: Pse keni shkuar atje?

Haki Isufi: Për të pirë kafe.

Prokurori Publik: Vetëm?

Haki Isufi: Jam nisur vetëm dhe gjatë rrugës e takova një person nga i njëjti fshat nga i cili jam.

Prokurori Publik: Me kënd keni shkuar?

Haki Isufi: E takova [redacted] dhe e mora me veti.

Prokurori Publik: Ku keni shkuar?

Haki Isufi: Kemi pirë bashkë kafe.

Prokurori Publik: Cka ju tha ajo, ku donte ajo me shkua?

Haki Isufi: Ajo më tha se donte me shkua në Viti sepse ajo merr pjesë në aktivitetet e vëllezimit.

Prokurori Publik: Thatë se keni pirë kafe, në cilën kafene?

Haki Isufi: Me heret quhej Kalaja kurse tani është Loni.

Prokurori Publik: deri në ora sa keni qëndruar me [redacted] A-L

Haki Isufi: Kam qëndruar deri në orën 13.45 ose 13.30.

Prokurori Publik: Pastaj, a keni shkuar dikund?

Haki Isufi: Pastaj, kam shkuar në një kafene tjetër që quhet Morena.

Prokurori Publik: Ku gjindet ajo kafeteri?

Haki Isufi: Një 200 deri 300 metra nga kafeteria Kalaja.

Prokurori Publik: A keni eë apo vozite deri atje?

Haki Isufi: Mendoj se kam shkuar me veturë por nuk jam i sigurt.

Prokurori Publik: A keni shkuar atje vetëm apo me dikënd tjetër?

Haki Isufi: Vetëm.

Prokurori Publik: Sa kohë keni qëndruar atje?

Haki Isufi: rreth një ore, pas orës dy.

Prokurori Publik: Vetëm apo i shoqëruar me dikënd?

Haki Isufi: U takova me një shok aty.

Prokurori Publik: Emri i tij?

Haki Isufi: [redacted] D.P.

Prokurori Publik: Deri në orën sa keni qëndruar me të?

Haki Isufi: Me të kam qënë deri në orën 14.00 ose 14.15.

Prokurori Publik: Ku keni shkuar pastaj?

Haki Isufi: Në shtëpi.

Prokurori Publik: Vetem apo me dikend tjetër?

Haki Isufi: Vetem.

Prokurori Publik: A i njeh personat tjerë të cilët janë akuzuar?

Haki Isufi: Nuk e njoh vetem Farukun, të gjithë tjerët i njoh.

Prokurori Publik: Duke filluar nga Burim Berisha, si i njihni të tjerët, a jeni raporte familjare me ta?

Haki Isufi: Me Burim Berishën jam njohte diku në gushtin e vitit 2007. Siq thash jam njohte me Burim Berishën sepse ai ishte ulur bashkë me Fatosin. Une ju kam bashkëngjite atyre dhe ata ishin duke biseduar lidhur me punësimsepse unë poashtu isha i intersuar. Une e takova atë aty dhe kisha nevojë për punë. E pyeta se mos kishte mundësi me bë dikë. Une isha i intersuar. Pastaj, ai më tha se çfarë dokumentesh më nevojiteshin për t'i sjell. I kam pagatite dhe ia kam dorëzuar Burim BERISHES, në shtëpinë e tij në Ferizaj dhe përveq tyre ia dhash edhe 2000.00 Euro për t'u punësuar.

Prokurori Publik: A të tha Burim Berisha se duhesh me i dhënë 2000.00 Euro?

Haki Isufi: Po.

Prokurori Publik: A u punësove?

Haki Isufi: E bera trajnimin dhe më me intervistuan dhe kjo ishte në shkollën fillore Iliria. Dhe intervista është bërë në afersi të zyrës kryesore të partisë politike Ora, diku në atë pjesë të qytetit. Ishte në muajin ramazan kur e pata trajnimin dhe me intervistuan. Pas një jave shkuam për trajnim.

Prokurori Publik: Përveq punëve të bujqësisë, akeni punuar dik tjetër ndonjëherë?

Haki Isufi: Jo.

Prokurori Publik: A e njihni Xhelalin?

Haki Isufi: Ai është nga i njëjti fshat si unë.

Prokurori Publik: A e ke takuar atë me parë?

Haki Isufi: Para incidentit, nuk e kam takuar atë me parë.

Prokurori Publik: A e njihni Fikretin?

Haki Isufi: Ai është nga i njëjti fshat.

Prokurori Publik: Po Fatosin?

Haki Isufi: Ai është dhenderri im.

Prokurori Publik: Po Selami Beqirin?

Haki Isufi: Ai është dhenderri im.

.....(hiqet).....

Rrethanat se më 9 qershor 2008, Haki ISUFI ka shkuar me veturë nga fshati Terpeze në Viti, ku kaloi ca kohë prej përafërsisht 11:00 deri 12:30, në kafeterinë Kalaja se bashku me një person të quajtur [redacted] dhe pastaj me vonë, prej orës 12:30 deri 14:00, në kafeterinë Morena, se bashku me [redacted] është poashtu vertetur nga ana e dëshmitarëve. D.P.

Ky është një ekstrakt relevant nga procesverbali i dëshmitarëve se [redacted] A-L

Ahmet Ahmeti: Ju falemnderit. Që sa e njihni Hakiun?

A-L [redacted] Ate e njoh që një kohë të gjatë sepse jetojme në të njëjtin fshat.

Ahmet Ahmeti: A keni qenë shpesh në shoqëri të Hakiut?

A-L [redacted] Po, bukur shpesh.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A mund të saktësojmë këtë pyetje?

Ahmet Ahmeti: Sa shpesh keni qenë në shoqëri të Hakiut?

A-L [redacted] Po, kam qenë shpesh në shoqëri të Hakiut, por koheve të fundit jam shoqëruar me të më shpesh sepse ai më ka ndihmuar rreth organizimit të festimit të pavaresisë.

Ahmet Ahmeti: A ju kujtohet takimi i fundit me Hakiun?

A-L [redacted] Ishte saktësisht më 9 qershor.

Ahmet Ahmeti: A ju kujtohet ku ka ndodhur ky takim?

A-L [redacted] Une isha në fshatin tim dhe pasi që isha duke shkuar për atë koncertin për pavaresinë dhe sepse ekzistojnë vetëm tre autobusa që qarkullojnë për në koncert dhe gjatë rrugës për zënë autobusin dhe ai më pa dhe e ndali veturën.

- Ahmet Ahmeti: A i kujtohet deshmitares se ku kane shkuar?
- A-L [REDACTED]: Une isha duke shkuar ne Viti dhe Hakiu me mori dhe shkuam ne Viti.
- Ahmet Ahmeti: A keni shkuar ne ndonje bar apo a ju kujtohet se ku keni shkuar bashke?
- A-L [REDACTED]: Pasi arritem ne Viti, shkuam per te pire nga nje kafe ne nje bar dhe kemi pire kafe bashke.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Ne ora sa?
- A-L [REDACTED]: Une jam nise nga shtepia ne oren 10.45 dhe pastaj u takova me hakiun dhe mendoj se kjo ishte ne mes te ores 10.00 dhe 11.00 dhe pasi arritem ne Viti kemi pire kafe me Hakiun dhe kemi qendruar aty deri ne oren 12.30.
- Ahmet Ahmeti: Sipas pergjegjes se juaj, ju keni qene ne shoqeri me Hakiun ne mes te oreve 10.00 dhe 12.00, a eshte e vertete?
- A-L [REDACTED]: Po.
- Kryetari i Trupit Gjykses: 10.00 ose 1045.
- A-L [REDACTED]: Ne oren 10.45 jam nisur nga shtepia dhe jam takuar me te rreth ores 11.00. Kam qene ne shoqerine e tij deri 12.00.....(hiqet)....
- Sylejman Nuredini: A ju kujtohet emri i vendit ku keni pire kafe?
- A-L [REDACTED]: Po e di, quhej Kalaja, Castle ne gjuhen angleze.

Ky eshte nje fragment relevant nga proqesverbali i [REDACTED]: D-P

- Ahmet Ahmeti: A i kujtohet deshmitarit hera e fundit qe e ka takuar Hakiun para se ky i fundit te arrestohej?
- D-P [REDACTED]: E kam takuar kete te fundit me 9 qershor, ne dreke.
- Ahmet Ahmeti: Ku ka ndodhe ky takim?
- D-P [REDACTED]: Takimi ka ndodhe ne kafeterine Morena.
- Kryetari i Trupit Gjykses: Ku ne kafeterine Morena?
- D-P [REDACTED]: Ne Viti, ne Rrugen Tirana.
- Ahmet Ahmeti: Ju that ne dreke. A ju kujtohet koha, a ishte paradreke apo pas dreke?
- D-P [REDACTED]: Mendoj se ishte para ores 12.00 dhe ores 14.00 pas dreke.

P Gjykata nuk ka nevoje me dyshua ne besueshmerine e deshmitareve [REDACTED] dhe [REDACTED] pasi qe deshmitet e tyre kane qene plotesisht konsekuente. Megjithate, rrethana se Haki ISUFI ka kaluar kohen me ta prej ores 11:00 deri until 14:00 ne shoqerine e tyre kjo nuk perben alibine lidhur me akuzat ndaj tij. Gjykata e shpall te pandehurin fajtor jo qe te kete hyre ne banke por organizimin dhe mbeshtetjen e grabitjes.

Pas leximit te dosjes se gjyqit, Gjykata ka konstatuar se i pandehuri haki ISUFI ka kontaktuar te pandehurit tjere lidhur me grabitjen e bankes. Vlene te konstatojme se, ashtu siq ka ceke edhe i pandehuri gjate marrjes ne pyetje, Haki ISUFI veq e njihte Fatos AZIZIN i cili ishte dhenderri i tij dhe Selami BEQIRIN i cili ishte poashtu dhenderri i tij. Haki ISUFI poashtu ka deklaruar se ai e njihte Burim BERISHEN prej kohesh pasi qe ky i fundit eshte dashur ta ndihmonte per te gjetur pune ne cilesine e rojtarit te sigurise. Nga ana tjeter, Haki ISUFI ka deklaruar se ai nuk e njihte Xhelal AZIZIN dhe Fikret MURATIN.

Tash, do te theksohet se, nga matjet e thirrjeve telefonike del se ka pasur kontakte te shumta telefonike te Haki ISUFIT me te pandehurit tjere gjate diteve kritike.

Ne vecanti, nga matjet e thirrjeve telefonike:

Me 04.06.2008 ne oren 12:54:41 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 04.06.2008 ne oren 14:59:12 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 04.06.2008 ne oren 15:13:08 nga 4434 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 10:39:27 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 11:14:03 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 11:19:14 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 12:45:31 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 12:45:43 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 13:14:39 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 17:09:07 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 17:18:30 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 18:01:41 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 19:57:38 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 20:01:12 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 12:31:23 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 14:06:37 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 14:07:18 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 15:57:27 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:44:59 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:47:42 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 21:38:11 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 21:50:50 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 21:59:30 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:02:57 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:03:39 nga 44346 [redacted] ka thirre Selami Beqirin ne numrin 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:14:19 nga 44346 [redacted] ka thirre Fikret Muratin ne numrin 44534 [redacted]

SMS

Me 07.06.2008 19:57: Autor 44346291 Haki Isufi, Destinacioni 44534073 Fikret Murati, Statusi Eshte dorezuar, Porosia: E din ai (he knows);

Me 03.06.2008 ne oren 20:16:28 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 03.06.2008 ne oren 21:00:34 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 04.06.2008 ne oren 12:51:17 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 04.06.2008 ne oren 14:57:36 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 04.06.2008 ne oren 15:00:20 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 10:38:27 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 10:41:16 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 11:15:06 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 05.06.2008 ne oren 20:16:42 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 13:16:59 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 13:30:26 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:22:02 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:25:23 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:34:32 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:39:33 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:51:23 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:53:44 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 16:57:05 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 17:04:06 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 17:09:21 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 17:20:15 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 18:52:31 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 19:58:38 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 07.06.2008 ne oren 20:45:54 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 13:30:44 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Selami Beqiri nga 44121 [redacted]

Me 08.06.2008 ne oren 14:06:47 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 16:00:32 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Selami Beqiri nga 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 16:01:51 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Selami Beqiri nga 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:48:03 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:48:16 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:48:37 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 19:49:14 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 21:18:19 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:07:32 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Selami Beqiri nga 44121 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:13:32 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:14:56 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 08.06.2008 ne oren 22:16:14 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Fikret Murati nga 44534 [redacted]
Me 09.06.2008 ne oren 15:15:47 numri 44346 [redacted] eshte thirre nga Burim Berisha nga 44746 [redacted]

SMS

07.06.2008 18:52: Autori 44534 [redacted] Fikret Murati,, Destinacioni 44346 [redacted] Haki Isufi; Statusi Eshte dorezuar, Porosia: Hej thuj ati shokit qi mos ta pormen emnin ty (hey tell that friend not to mention your name).

Lidhur me keto kontakte jashtezakoni sht te shpeshta me te pandehurit, sidomos me Fikret MURATIN, per te cilin ai tha se nuk e njihite fare, ai nuk ka mund te ofroje asnje spjegim logjik dhe te besueshem, ashtu siq del nga ky fragment nga marrja ne pyetje:

Andrea Cruciani: A ju kujtohet nese i kemi telefonuar Selami Beqirit me 8 qershor 2008?

Haki Isufi: Nuk e di nuk me kujtohet.

Andrea Cruciani: Nga matja e telefonit, a eshte numri i juaj 044 34 6 [redacted]?

Haki Isufi: Po.

Andrea Cruciani: Nga matjet e thirrjeve telefonike, mund te verej se me 8 qershor 2008, prej ores 21.30 deri me 22.00, kane qene pese (5) tentime per te thirre numrin 044 12 1 [redacted] cili eshte numri qe i takon Selami Beqirit, a eshte kjo e mundshme?

Haki Isufi: Ne jemi te lidhur familjarisht dhe ndonjehere femijte luajne me telefon. Nuk me kujtohet.

Andrea Cruciani: Prej ores 09.30 deri me 10.00 ne mbremje, a po mundoheni t'i tregoni gjyqit se femijte e juaj e kane marre telefonin dhe kane tentuar ta therrasin Selami Beqirin?

Haki Isufi: Ndonjehere femijte luajne me telefon.

Ahmet Ahmeti: A jane tentime per te thirre apo jane telefonata?

Andrea Cruciani: Une thash tentime per te thirre.

Gjykata konstaton se eshte e qarte se deklaratat mbrojtese te ilustruara te te pandehurit nuk jane te besueshme. I pandehuri ka tentuar me binde kete koleg me argumentet shfajesuese, te cilat haptazi jane trilluar. Eshte absolutisht e palogjikshme dhe e papranueshme se femijte e te pandehurit e kane perdore telefonin e babes vone ne mbremje dhe se e kishin thirre disa here te pandehurin tjeter Selami BEQIRIN. Eshte e qarte, perkundrazi, se thirrjet telefonike te cilat jane bere gjate mbremjes se 8 qershorit 2008 ne mes te Haki ISUFIT dhe Selami BEQIRIT ishin lidhur me veturen qe duhej te sigurohej nga ky i fundit per grabitjen e bankes te nesermen.

Gjithashtu, Haki ISUFI nuk mundi ne asnje menyre cfaredocofte t'i spjegoje mesazhet qe i ka marre nga Fikret MURATI:

Andrea Cruciani: Me 7 qershor 2008, e kemi raportin ketu, per nje mesazh qe iu eshte derguar nurmit te telefonit te juaj, nga numri i telefonit te Fikret MURATIT, qe ishte, po citoj: "Hej, thuaj shokut tende qe ta mos permend emrin tend". A mund te spjegosh kete?

Haki Isufi: Nuk e di.

Andrea Cruciani: Me 8 qershor, ne oren 10.00 ne mbremje, ju keni pranuar nje mesazh tjetër, i cili poashtu vinte nga Fikret MURATI, po citoj: "Hej njeri, jam teper i lodhur, nuk po mundem me e perballue me". A pu kujtohet qe e keni marre kete mesazh?

Haki Isufi: Nuk me kujtohet.

Andrea Cruciani: A ju kujtohet se keni marre tre mesazhe nga Fikret MURATI me 8 qershor?

Haki Isufi: Nuk me kujtohet.

Vec kesaj dhe me e rendesishmja, pergjegjesia kriminale e te pandehurit Haki ISUFIT del nga deklaratat e te bashkepandehurit Fikret MURATIT qe ia ka dhene policise me 10 qershor 2008, kur ishte i shoqeruar nga avokati i tij Nexhat QORROLLI, dhe te cilat do te konsiderohen si prova te pranueshme ne pajtim me Nenin 157 dhe 157 te KPPK-se. Deklaratat e permendura tashme jane raportuar ne teresi ketu me larte, keshtu qe ne vijim eshte vetem nje fragment relevant:

"Une, Fikret Murati deklaroi se jam takuar me Hakiun te merkuren ne fshatin Terpeze dhe ai me ka thene: "Nese mundesh me gjete dikend qe mundet me hy ne bank per t'i marre te hollat, dhe per kete do te shprblehesh nese mundesh me gjete dikend". Une i thash se kete vet nuk mundem me e be por do te mundohem me e gjete dikend tjetër per kete pune. Pas 1 apo 2 diteve une dhe Hakiu erdhem ne Ferizajme veturen "Rover" te Hakiut. Hakiu ka biseduar me Burimin dhe une u involvova ne bisede pas nja 10 minutave dhe Hakiu me tha se "nese e gjene personin, ai (Burimi) eshte i gatshem me e realizue operacionin ne banke te henen".... (omissis)....

Rreth ores 12:15 dikush me thirri ne telefonin tim dhe me tha: "Shko te koder, sepse Xhelali do te vije tash dhe ai do t'i sjell te hollat". Une shkova te kodra e cila eshte afer shtepise sime, aty ishte Xhelali me me nje cante sportive te ngjyres se vishnjes se mbyllte, pas nje kohe arriti Hakiu, Xhelali e ka hapur canten dhe ne te trete i kemi pare te hollat, dhe hakiu tha se askush nuk guxon me i preke te hollat derisa te vjen Burimi ketu, perndryshe ai qe i preke do te vritet". Une e mora canten dhe e solla te shtepia e xhaxhait (vellau i babes tim) dhe e lash ne tavan (hapesira nen kulm) dhe dola jashte ne fshat. Burimi me thirri ne telefon dhe me tha: "Ku do te takohemi?" mirepo Hakiu me kishte thene me heret: "Une do te mbylli telefonin tim, dhe nese Burimi therret thuaj se do te takohemi ne kafe-barin perballe xhamise ne Viti". Dhe une i thash Burimit qe te takohemi atje. Une shkova ne vendin e caktuar, e takova Burimin dhe Fatosin aty dhe qe te trete jemi arrestuar ne te njejten kafe-bar nga ana e policise.

Pyetje dhe pergjigje:

- Si i ke njohte Burimin, Fatosin, Hakiun, Selamiun dhe Xhelalin?
- Hakiu dhe Xhelali jane bashkefshataret e mi (ne jetojme ne te njejtin fshat), Hakiu me ka njoftua me Burimin para 4 apo 5 diteve, dhe Fatosi eshte dhenderri (burri i motres) i Hakiut dhe me te jam njohtuar para 3 diteve, dhe une e njoh Selamiun sepse ai eshte i martuar me nje kusherire te nezes sime.
- Sa ishte shuma e te hollave qe Hakiu te kishte premtuar me t'i dhene nese e gjene personin per te hyre ne banke?
- Ai nuk e ka percaktuar nje cmim, por ka thene se une do te mirrja nje shperblim.
- Me kend eshte marre vesh Selamiu me ia dhene veturen grabitesve te bankes?
- Hakiu me ka thene qe te thirra Selamiun me telefonin tim, te shkoja ne Terpeze dhe qe te arrija nje marreveshje lidhur me veturen.
- A ishte i pranishem atchere kur arriti Selamiu aty dhe cka eshte diskutuar aty?
- Selamiu ka ardhur ne Terpeze te dielen, kurse une, Hakiu dhe selamiu jemi takuar ne fshat, atje ata dy u pajtuan qe Selamiu do te linte veturen ne oborrin e shtepise pa e mbyll me qeles dhe poashtu

do t'i linte qelesat ne veture per Xhelalin qe te vinte dhe te mirrte veturen ne mengjes. Dhe keshtu eshte vendosur qe selamiu te linte veturen sipas marreveshjes.

- A eshte diskutue aty me Selamium se cfare do behej lidhur me veture?
- Po. Hakiu i tha Selamiut: "Rreth ores 09.30 shko ne polici dhe lajmeroji se vetura e jote eshte vjedhur", dhe Selamiu pranoi.....(omissis)...

Te gjitha elementet e permendura vertetojne pertej cdo dyshimi te arsyeshem involvimin e Burim BERISHES ne grabitjen e bankes, pergjegjesi kryesor i kryerjes se kesaj vepre, bashke me Burim BERISHEN dhe Xhelal AZIZIN. I pandehuri ka kryer nje veper kriminele, e cila me te drejte do te kualifikohet si grabitje, ne kundërshtim me nenin 255 (1)-(3) te KPK-se, duke i permbushur elementi material (actus rei) dhe elementin psikologjik (dolus) te nje krimi te tille. Ne vecanti, Haki ISUFI e ka pyet Fikret MURATIN qe te gjeje nje person tjetër me te cilin Burim BERISHA do te grabiste banken dhe pastaj ia ka siguruar Burim BERISHES tere mbështetjen e nevojshme pas realizimit te grabitjes se bankes per t'i siguruar te hollat. Ne te vertete, Haki ISUFI poashtu kishte shkuar ne shtepine e xhaxhait te Fikret MURATIT per te kontrolluar se a mbahej canta me te holla ne menyre te sigurt aty. Vec kesaj ai e ka kontaktuar dhenderrin e tij Selami BEQIRIN qe te siguroje veturen qe eshte perdore gjate grabitjes se bankes.

4. Pergjegjesia kriminale e Fikret MURATIT.

Fikret MURATI eshte arrestuar nga policia kur ai ishte i ulur ne nje kafeteri ne Viti se bashku me Burim BERISHEN dhe Fatos AZIZIN. Pas arrestimit te tij, Fikret MURATI ka qene shume kooperues me policine dhe deklaratat e tij te dhene pas ngjarjes kane qene te nje rendesie shume te madhe per t'i ndrikuar hetimet, per t'i vecuar pergjegjesite individuale te te pandehureve tjere dhe per te cartesuar rolin dhe pergjegjesine e cdo njerit prej tyre ne grabitjen e bankes.

Rendesia e kooperimit te Fikret MURATIT gjate hetimeve eshte poashtu vertetuar edhe nga ana e [REDACTED], hetuesit te policise, gjate deklarates se tij:

D-R.

Aziz Rexha: A ishte Fikret Murati kooperues gjate marrjes ne pyetje? A ka kontribuar ne ndrqimin e e ketij rasti kriminal?

B-R. [REDACTED] Po, Fikret Murati ishte shume kooperues. Cdo gje qe ka thene ka qene shume e rendesishme per ne.

Deklaratat e Fikret MURATIT qe i ka dhene policise me 10 qershor 2008 jane te nje rendesie kruciale per rastin e tanishem, kur ai ishte i shoqeruar nga avokati i tij Nexhat QORROLI:

"Une, Fikret Murati deklarohet se jam takuar me Hakiun te merkuren ne fshatin Terpeze dhe ai me ka thene: "Nese mundesh me gjete dikend qe mundet me hy ne bank per t'i marre te hollat, dhe per kete do te shprblehesh nese mundesh me gjete dikend". Une i thash se kete vet nuk mundem me e be por do te mundohem me e gjete dikend tjetër per kete pune. Pas 1 apo 2 diteve une dhe Hakiu erdhem ne Ferizajme veturen "Rover" te Hakiut. Hakiu ka biseduar me Burimin dhe une u involvova ne bisede pas nja 10 minutave dhe Hakiu me tha se "nese e gjene personin, ai (Burimi) eshte i gatshem me e realizue operacionin ne banke te henen". Pasi qe shkuam ne shtepi, e takova

bashkefshatarin tim (fqiu) Xhelalin dhe e pyeta: "A ta merr mendja se mundesh me hy ne banke per t'i marre te hollat nga ajo, dhe Xhelali me tha "Une do te hyj". Te shtunen, une dhe Xhelali erdhem ne Ferizaj ne nje kafe-bar ne rrugen e Gjilanit ku u takuam me Burimin. Aty Burimi, gjate bisedes me Xhelalin, ne mes tjerash i ka thene: "Nese me tradheton, me mire eshte te mos hysh fare, sepse atehere ti do te jesh i pari qe do ta vras e pastaj te tjeret sepse une policise nuk i dorezohem gjalle pa i shfrytezua te gjithë plumbat qe i kam". Xhelali tha: "Une nuk do te te tradhetoj". Pastaj Burimi i tha Xhelalit se: "Ti do te qendrosh te dera e bankes derisa une, une do t'i marr te hollat nga arka sepse une e di vendin saktesisht se ku gjinden ato". Aty, Xhelali dhe Burimi e caktuan kohen qe te takohen te henen ne oren 07.30 nebanesen e Burimit ne Ferizaj. Te henen me 09/06/2008 erdha ne Ferizaj me veturen time Mercedes, kurse Xhelali erdhi me Golfin e Selamiut dhe u takuam ne banesen e Burimit. Une menjehere u ktheva ne shtepi kurse i lash ata te dy ne banesen e Burimit. Ne oren 08:15 Burimi me thirri ne telefon dhe me tha: "A po vjen me me marre ke Kisha katolike ne Ferizaj?", dhe une i thash: "Jo, nuk do te vij". Rreth ores 12:15 dikush me thirri ne telefon dhe me tha: "Shko te kodra sepse Xhelali do te vijtash dhe ai do t'i sjell te hollat". Une shkova te kodra e cila eshte afer shtepise sime, aty ishte Xhelali me nje cante sportive te ngjyres vishnje te mbyllt, pas nje kohe te shkurte arriti edhe Hakiu, Xhelali e hapi canten dhe ne te tre i kemi pare te hollat, dhe Hakiu tha se askush nuk guxon me i preke te hollat derisa te vjen Burimi ketu, perndryshe ai qe i prek do te vritet". Une e mora canten dhe e dergova te shtepia e xhaxhait tim (vellau i babait tim) dhe e lash ne tavan (hapesira nen kulm) dhe dola jashte ne fshat. Burimi me thirri ne telefon dhe me tha: "Ku do te takohemi?" mirepo Hakiu me kishte thene me heret se: "Une do te mbylli telefonin timdhe nese Burimi te therret ty thuaj se do te takohemi ne nje kafe-bar prball xhamise ne Viti". Dhe i thash Burimit qe te takohemi aty. Une shkova ne vendin e caktuar, e takova Burimin dhe Fatosin aty dhe ne te njejten kafe-bar qe te tret u arrestuam nga ana e policise.

Pyetje dhe pergjigje:

- Si i ke njohte Burimin, Fatosin, Hakiun, Selamiun dhe Xhelalin?
- Hakiu dhe Xhelali jane bashkefshataret e mi (ne jetojme ne te njejtin fshat), Hakiu me ka njoftua me Burimin para 4 apo 5 diteve, dhe Fatosi eshte dhenderri (burri i motres) i Hakiut dhe me te jam njohtuar para 3 diteve, dhe une e njoh Selamiun sepse ai eshte i martuar me nje kusherire te nenes sime.
- Sa ishte shuma e te hollave qe Hakiu te kishte premtuar me t'i dhene nese e gjene personin per te hyre ne banke?
- Ai nuk e ka percaktuar nje cmim, por ka thene se une do te mirrja nje shperblim.
- Me kend eshte marre vesh Selamiu me ia dhene veturen grabitesve te bankes?
- Hakiu me ka thene qe te thirrja Selamiun me telefonin tim, te shkoja ne Terpeze dhe qe te arrija nje marreveshje lidhur me veturen.
- A ishte i pranishem atehere kur arriti Selamiu aty dhe cka eshte diskutuar aty?
- Selamiu ka ardhur ne Terpeze te dielen, kurse une, Hakiu dhe selamiu jemi takuar ne fshat, atje ata dy u pajtuan qe Selamiu do te linte veturen ne oborrin e shtepise pa e mbyll me qeles dhe poashtu do t'i linte qelesat ne veture per Xhelalin qe te vinte dhe te mirte veturen ne mengjes. Dhe keshtu eshte vendosur qe selamiu te linte veturen sipas marreveshjes.
- A eshte diskutue aty me Selamiun se cfare do behej lidhur me veture?
- Po. Hakiu i tha Selamiut: "Rreth ores 09.30 shko ne polici dhe lajmeroji se vetura e jote eshte vjedhur", dhe Selamiu pranoi.
- Deri ne c'mase eshte Fatosi i involvuar ne kete rast?

- Aq sa di une, Fatosi e ka gjete personin detyra e te cilit ishte qe t'i largonte ata nga Ferizaji dhe per kete ai do te mirrte 10000 Euro, dhe nga kjo shume e te hollave Fatosi eshte dashur te paguante personin me veturen Vectra.
- A din se nga vjen ky personi me veturen Vectra?
- Aq sa di une, ai ishte nga fshati Kabash, Viti, por une nuk ia di emrin.
- Kush ka hyre brenda ne banke per t'i marre te hollat?
- Xhelali dhe Burimi kane hyre ne banke.
- A je i sigurt per ate qe po e thua?
- Jam plotesisht i sigurt per kete.
- A keni dic tjeter per te shtuar ne kete deklarate?
- Jo, nuk kam.

Me 17 korrik 2008, para Prokurores Publike Sevdije MORINA, me ndihmen e avokatit sipas zgjedhjes se tij Aziz REXHES, i opandehuri dha deklarata tjera te cilat plotesisht dalloheshin nga ato te meherishmet. Keto jane deklaratat e te pandehurit qe i ka dhene me ate rast.

"Me 09.06 2008, rreth ores 06.50, u largova nga shtepia ne fshatin Terpeze per te shkuar ne Ferizaj sepse me duhej te shkoja te shtepia e xhaxhait tim per t'i marr ca zgjua. Gjate rruges sime derisa isha ne fshatin Terpeze u ndalova nga Xhelali, bashkefshatari im i cili me luti qe te mirrja me veti deri ne fshatine Sllatine. Ai me tha duhej te mirrte nje veture atje. Une isha me Mercedesin tim te ngjyres se kuge. E mora Xhelalin deri ne Sllatine dhe pastaj e vazhdova rrugen per ne Ferizaj. Pasi bera ate qe kisha per te bere ne Ferizaj, rreth ores 08.15 u ktheva dhe rrash me fjete.

Ne oren 12.00, Xhelali erdh te shtepia ime dhe me thirri. Kur dola jashte e pashe Xhelalin me nje cante sportive te ngjyres se vishnjes. Ai kerkoi prej meje qe te dergoj dhe te fshehi ne shtepine e xhaxhait tim. E mora canten dhe bashke me Xhelalin e derguamate ne tavanin e shtepise. Xhelalin nuk e kam pyet se cka kishte ne cante dhe ai s'me ka tregua fare. Pasi e lame canten, shkuam te dera e shtepise dhe a takuam Haki ISUFIN aty, i cili poashtu eshte nga fshati Terpeze. Nuk e di se pse hakiu kishte ardhur te dera ime. Ai nuk tha asgje.

Pas kesaj, Xhelali dhe Hakiu shkuan kurse une hyra ne shtepi, u veshja, e mora veturen time dhe shkova ne Viti. Distanca prej fshatit tim deri ne Viti eshte 8 km. Kur u ndava nga Hakiu dhe Xhelali nuk iu kam thene fare se po shkoja ne Viti. Ata nuk me pyeten fare. Une shkova ne kafeterine "Picasso", e cila gjindet ne shtepine e mallerave. Aty kam qendruar vetem me pronarin e kafeterise.

Ne mbremje Burim BERISHA me telefonoi duke me pyetur se ku do te takoheshim. In the evening Burim Berish phoned me, asking me where to meet each other. Ai vet propozoi qe te takoheshim perballe xhamise ne Viti. Kete bisede e kam bere derisa isha ne "Picasso". Nuke kam njohte Burimi me pare fare dhe nuk e di se qe e mundur qe te me telefononte. Pas 10 - 15 minutave shkova ne kafeteri, ku me kishte thene Burimi qe te shkoja, dhe perveq Burimit e takova nje person te quajtur Fatos AZIZI te cilin poashtu nuk e kisha pare kurse me pare. Sa u takuam policia na rrethoi dhe na arrestoi. Ne mbremje kur policia pyeti per te hollat, une iu tregova lidhur me canten te cilen Xhelali ma kishte sjell dhe une ua tregova vendin ku e kisha fshehur ate.

I pandehuri pergjigjet ne pyetjen e bere: "Une e njoh Selami BEQIRIN. Ai eshte nga fshati Sllatina e Eperme. Ai eshte i martuar me kusheriren e neves sime. Perveq pershendetjeve nuk kam ndonje shoqeri me te dhe rrale e kam takuar. Nuk e di se kush

eshte Faruk ADEMI". Te pandehurit i perkujtohet deklarata qe a ka dhene ne polici dhe eshte pyetur per ndryshimet qe i ka be sot. Ai deklaroi: "Ate qe e kam thene ne stacionin e policisenuk eshte evretete. Me kane detyruar sepse policia me ka rrah. Une e kam nenshkruar proqesverbalin ne stacionin e policise mirepo nuk e kam lexuar ate paraprakisht. Asgje nga ajo qe kam deklaruar ne stacionin e policise lidhur me marreveshjet dhe premtimet e meherishme per rryshfet, pas perfundimit te punes, nuk eshte e vertete.

Ne pyetjen e avokatit, i pandehuri pergjigjet: Ferizaji eshte 23 km nga fshati Terpeze. Nga fshati Sllatine ku e pata lene Xhelalin distanca deri ne Ferizaj eshte 16 km. Veturen qe e kam perdore ne ate dite e ka babai im ne Gjermani, diku pas vitit te ri. Une jam i semuar qe nga muaji tetor 2007 dhe jam operuar ne Shqiperi,... (rreshiti i plote nuk eshte printuar).

Kjo eshte deklarata ime. Nuk kam asgje tjeter per te deklaruar. Kjo me eshte lexuar dhe te njejten e nenshkruaj pa verejtje".

Keto deklarata do te konsiderohen si te pabesueshme. Eshte e paligjishme qe i pandehuri u takua me bashkefshatarin, Xhelal AZIZIN, aq heret ne mengjes, derisa ai kinse ishte nisur per te shkuar ne shtepine e xhaxhait te tij per te marre ca zgjua dhe ate e mori ne veturen e tij per cuar deri ne nje fshat tjeter bile as pa e pyet pse shkonte ai atje. Ne menyre te ngjajshme, eshte edhe me e pabesueshme se i pandehuri e ka fsheh canten ne shtepine e xhaxhait te tij ne baze te kerkeses se Xhelal AZIZIT pa e pyetur se pse dhe cka kishte ne cante. Poashtu, nuk eshte e besueshme qe haki ISUFI te vije ne shtepine e xhaxhait te tij pa asnje arsye dhe se ai nuk e ka pyet per arsyen e ardhjes se tij. Gjithashtu, nuk eshte e besueshme qe i pandehuri Burim BERISHA, per te cilin Fikret MURATI pohon se nuk e kishte njohur me pare, e ka pase numrin e telefonit te tij dhe e ka thirrur ne telefon per te aranzhuar nje takim ne nje kafeteri ne Viti pa asnje arsye te qarte. Perfundimisht, arsyetimi per ndryshimet konsistente lidhur me deklarata e dhena me heret para policise nuk eshte i besueshem. I pandehuri pohonte se kinse policia e ka rrahur ate gjate deklaratave te para, pra duke e detyruar qe t'i nenshkruaj ato. Lidhur me te mjafton te thuhet se avokati ka qene i pranishem ne kohen kur jane dhene deklaratat dhe se nuk ekziston asnje prove e vetme qe shkon ne favor te verzionit te fundit te ngjarjeve, te cilat ne menyre te qarte jane trilluar nga i pandehuri. Vec kesaj, Fikret MURATI ka vendose per te mos folur gjate gjykimit duke mos i mundesuar gjykates te kerkoje spjegimin per ndryshimet ne fjale.

Perkundrazi, deklaratat e bera para policise me 10 qershor 2008, pas ngjarjeve, jane jashtezakonisht te hollesishme dhe konsistente. Ato nuk paraqesin asnje element te papajtueshem dhe ato ne menyre te persosur perputhen me te gjitha provat te cilat jane tubuar gjate hetimeve.

Poashtu do te theksohet se deklaratat e Fikret MURATIT nga 10 qershori 2008 nuk jane te vetme prova kunder tij. Ne te vertete, matja e bisedave telefonike kavertetuar ne menyre te pakontestueshme se Fikret MURATI ka pase nje numer shume te madh te kontakteve telefonike me te pandehurit tjere per organizimin e grabitjes se bankes. Ne vecanti, shumica e thirrjeve dhe tentimeve per thirrje jane regjistruar ne mes Fikret MURATIT me numrin e telefonit te tij 044534 [REDACTED] Xhelal AZIZIT dhe Haki ISUFIT

gjate diteve para 9 qershorit 2008. Posacerisht Fikret MURATI ka mbete ne kontakt me Haki ISUFIN deri vone ne mbremjen para grabitjes se bankes dhe me Faruk ADEMIN-per te cilin ne deklaratat e dhena para Prokurorit Publik heret ne mengjesin e 9 qershorit 2008 vetem disa minuta pas grabitjes se bankes pohon se nuk e njeh.

Në veçanti nga, tabulatet telefonike të bisedave:

Më 03.06.2008 në orën 18:39:07 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 03.06.2008 në orën 19:22:51 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 03.06.2008 në orën 20:16:28 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 03.06.2008 në orën 21:00:34 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 04.06.2008 në orën 12:51:17 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 04.06.2008 në orën 14:57:36 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 04.06.2008 në orën 15:00:20 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 05.06.2008 në orën 10:38:27 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 05.06.2008 në orën 10:41:16 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 05.06.2008 në orën 11:15:06 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 05.06.2008 në orën 20:16:42 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 05.06.2008 në orën 20:43:01 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 21:39:18 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 21:39:59 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 21:40:24 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 21:41:25 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 21:43:40 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 05.06.2008 në orën 22:03:10 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:34:56 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:35:57 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:36:32 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:37:48 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:44:22 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:52:03 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 09:52:33 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 0:24:57 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 11:18:49 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 16:39:45 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 20:51:42 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 20:59:58 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 21:41:55 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizini në numrin e telefonit: 044323

Më 06.06.2008 në orën 21:42:28 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 06.06.2008 në orën 21:58:29 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 06.06.2008 në orën 21:59:43 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 07.06.2008 në orën 11:18:52 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 07.06.2008 në orën 12:37:18 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 07.06.2008 në orën 13:16:59 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 13:30:26 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:22:02 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:25:23 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:34:32 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:39:33 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:51:23 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:52:51 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 07.06.2008 në orën 16:53:44 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:57:05 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 16:57:17 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 07.06.2008 në orën 17:04:06 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 17:07:28 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 0444430
Më 07.06.2008 në orën 17:09:21 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 17:20:15 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 17:48:20 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 07.06.2008 në orën 18:52:31 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 19:58:38 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 07.06.2008 në orën 20:45:54 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 09:46:03 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 14:06:47 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 15:08:40 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:10:47 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:12:13 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:15:14 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:15:40 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:16:21 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 15:17:19 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 16:27:13 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 19:48:03 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 19:48:16 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 19:48:37 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346

Më 08.06.2008 në orën 19:49:14 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 20:10:43 numri 044534 ka telefonuar Selami Beqirin në numrin e telefonit: 044121
Më 08.06.2008 në orën 20:49:55 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 20:52:24 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 08.06.2008 në orën 21:17:49 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 21:18:19 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 21:18:50 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 21:52:02 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 21:53:13 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 22:11:58 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 22:13:32 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 22:14:56 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 22:15:33 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 049443
Më 08.06.2008 në orën 22:16:14 numri 044534 ka telefonuar Haki Isufin në numrin e telefonit: 044346
Më 08.06.2008 në orën 23:21:47 numri 044534 ka telefonuar Xhelal Azizin në numrin e telefonit: 044323
Më 09.06.2008 në orën 08:19:52 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 08:19:56 numri 044534 ka telefonuar Fatos Azizin në numrin e telefonit: 049668
Më 09.06.2008 në orën 08:31:44 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 08:46:10 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 09:46:10 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 09:51:08 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 10:01:15 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 10:12:29 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783
Më 09.06.2008 në orën 10:16:22 numri 044534 ka telefonuar Faruk Ademin në numrin e telefonit: 044783

Telefonatat e marra në numrin e Telefonit të Fikret Muratit: 044534073

Më 04.06.2008 në orën 12:54:41 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 04.06.2008 në orën 14:59:12 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 04.06.2008 në orën 15:13:08 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 10:39:27 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 11:14:03 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 11:19:14 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 12:24:15 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 12:45:31 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 12:45:43 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534

Më 05.06.2008 në orën 13:14:39 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 17:09:07 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 17:18:30 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 05.06.2008 në orën 18:01:41 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 19:57:38 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:01:12 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:22:24 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:24:24 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:26:07 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:29:06 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:30:21 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 07.06.2008 në orën 20:35:19 Haki Isufi, nga numri 044650 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 14:06:37 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 14:07:18 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 19:44:59 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 19:47:42 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 20:46:06 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 22:14:19 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 22:14:19 Haki Isufi, nga numri 044346 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 08.06.2008 në orën 22:17:43 Selami Beqiri, nga numri 044121 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 09.06.2008 në orën 10:11:58 Faruk Ademi, nga numri 044783 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 09.06.2008 në orën 10:13:56 Faruk Ademi, nga numri 044783 ka marrë në telefon numrin: 044534
Më 09.06.2008 në orën 21:23:37 Faruk Ademi, nga numri 044783 ka marrë në telefon numrin: 044534

Së fundi, ekziston një raport policie në lidhje me bastisjen e shtëpisë së xhaxhait të të pandehurit, i cili tregon se në tavanin e shtëpisë u gjet një çantë me ngjyrë qershie me para.

Nga të gjitha pjesët e mësipërme të përmendura të provave, Gjykata ka arritur në përfundimin se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, përgjegjësia penale e të pandehurit Fikret MURATI. I pandehuri e ka kryer veprën penale, e cila me të drejtë do të kualifikohet si Grabitje, në kundërshtim me Nenin 255 (1)-(3) të KPK, duke përmbyshur si elementin material (*actus rei*) ashtu edhe elementin psikologjik (*dolus*) të një krimi të tillë. Ai ka qenë personi që ka kontaktuar, me kërkesën e Haki ISUFIT, bashkëfshatarin Xhelal AZIZI për të hyrë në bankë, dhe ka qenë ai që ka fshehur çantën sportive me ngjyrë qershie në shtëpinë e xhaxhait të tij.

5. Përgjegjësia penale e Fatos AZIZIT.

Pas rishikimit të çështjes, Trupi Gjykses ka arritur në përfundimin se i pandehuri Fatos AZIZI, që është edhe dhëndri i Haki ISUFIT, është gjithashtu përgjegjës për grabitjen e bankës që ndodhi më 9 qershor 2008.

Gjatë marrjes së tij në pyetje, i pandehuri i ka mohuar të gjitha akuzat kundër tij:

Prokurori Publik: Çfarë dini për grabitjen e bankës në Ferizaj, çfarë dini në lidhje me të? A ju kanë informuar në lidhje me të?

Fatos Azizi: Pasi më arrestoi policia.

Prokurori Publik: A e njihni Burim Berishën?

Fatos Azizi: Po.

Prokurori Publik: Si?

Fatos Azizi: E njoh që në vitin 2007.

Prokurori Publik: Kush të ka prezantuar ty më të?

Fatos Azizi: Një i afërm.

Prokurori Publik: A e keni takuar atë shpesh?

Fatos Azizi: Po, e kam takuar.

Prokurori Publik: A ishin takimet të një natyre shoqërore?

Fatos Azizi: Për qëllimet e punësimit.

Prokurori Publik: Çfarë lloj punësimi?

Fatos Azizi: Sigurim.

Prokurori Publik: Ku?

Fatos Azizi: Në bankë.

.....*(hiqet)*.....

Prokurori Publik: A e njihni Haki Isufin?

Fatos Azizi: Po.

Prokurori Publik: A e takuat atë ditën e incidentit?

Fatos Azizi: Po, isha në shtëpinë e tij më parë.

Prokurori Publik: Në çfarë ore?

Fatos Azizi: Në orën një.

Prokurori Publik: Ku ishit ju?

Fatos Azizi: Tek Hakiu.

Prokurori Publik: Në shtëpinë e tij?

Fatos Azizi: Po.

Prokurori Publik: A kalove kohë me të?

Fatos Azizi: Po, sepse ai është dhëndri im.

...*(hiqet)*.....

Shemsedin Piraj: Përpara ditës së arrestimit, a keni punuar me Faruk Ademin?

Fatos Azizi: Po.

Shemsedin Piraj: Çfarë bënit bashkë?

Fatos Azizi: Unë punoja me pllaka.

.....*(hiqet)*.....

Bajram Krasniqi: Ju thoni që Haki Isufi është mik i familjes, a e njihni Selami Beqirin?

Fatos Azizi: Po.

Bajram Krasniqi: A e njihni atë si shok të Haki Isufit?

Fatos Azizi: Vetëm si shok të Haki Isufit.

Edhe një herë, provat më të rëndësishme kundër të pandehurit Fatos AZIZI janë dëshmitë e të bashkë-akuzuarit Fikret MURATI, dhënë policisë më 10 qershor 2008. Dëshmitë në fjalë janë raportuar tashmë plotësisht më sipër, prandaj tani kemi vetëm një paragraf relevant, që vijon si më poshtë:

-Deri në çfarë mase është Fatosi i përfshirë në këtë çështje?

-Me sa e di unë, Fatosi ka gjetur personin, detyra e të cilit ishte t'i nxirrte nga Ferizaji, dhe për këtë ai do të merrte 10000 Euro, dhe nga këto para Fatosi supozohej të paguante personin me makinën Vektra.

Me të vërtetë kjo rrethanë është mbështetur gjithashtu edhe nga provat të tjera në dosjen e lëndës. Në veçanti, i pandehuri Fatos AZIZI ka qenë personi që ka kontaktuar një bashkëpunëtor, Faruk ADEMIN, duke i kërkuar atij të bashkohej me Xhelal AZIZIN në pyll për të lënë çantat e Pro-Credit-it dhe për të vënë paratë në çantën me ngjyrë qershie.

Në veçanti, këto janë telefonatat e marra që kanë rezultuar nga tabulatet telefonike të numrit të telefonit të Faruk ADEMIT:

Më 09.06.2008 në orën 10:26:04 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 11:10:15 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 11:38:02 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 20:52:37 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 20:59:51 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 21:06:24 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 21:07:48 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 21:09:27 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Më 09.06.2008 në orën 21:10:39 nga numri 44783 [redacted] ka marrë në telefon Fatos Azizin në numrin 49668990.

Për më tepër, tabulatet telefonike të telefonatave kanë provuar që, më 9 qershor 2008, në orën 08:19:56, afërsisht rreth dhjetë (10) minuta pas grabitjes së bankës në Ferizaj, i pandehuri Fikret MURATI, nga numri i telefonit 044534 [redacted], mori në telefon Fatos AZIZIN, në numrin e tij të telefonit 049668 [redacted].

Së fundmi, Fatos AZIZI u arrestua nga policia ndërsa ishte ulur në një kafene në Viti, së bashku me Burim BERISHËN dhe Fikret MURATIN.

Nga të gjitha pjesët e mësipërme të përmendura të provave, Gjykata ka arritur në përfundimin se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, përgjegjësia penale e të pandehurit Fikret MURATI. I pandehuri e ka kryer veprën penale, e cila me të drejtë do të kualifikohet si Grabitje, në kundërshtim me Nenin 255 (1)-(3) të KPK, duke përmbushur si elementin material (*actus rei*) ashtu edhe elementin psikologjik (*dolus*) të një krimi të tillë. Ai ka qenë personi që ka kontaktuar, me kërkesën e Haki ISUFIT, bashkëpunëtorin Faruk ADEMI që ky së bashku me Xhelal AZIZIN të shkonin në pyll e të vendosnin paratë në çantën sportive me ngjyrë qershie.

6. Përgjegjësia penale e Selami BEQIRIT.

Edhe i pandehuri Selami BEQIRI do të konsiderohet përgjegjës për grabitjen e bankës së datës 9 qershor 2008, meqë ai u siguroi ndihmë kryesve të tjerë të veprës penale. Në veçanti, i pandehuri, që është edhe kunati i Haki ISUFIT, i ka dhënë makinën Xhelal AZIZIT, që është një makinë Golf me ngjyrë jeshile, me numrin e targës 202-KS-943, që është përdorur gjatë grabitjes së bankës, me marrëveshjen paraprake që në ditën kritike më vonë ai do të raportojë në polici vjedhjen e makinës.

Selami BEQIRI zgjodhi të jepte dëshmi në Gjykatë dhe më poshtë po paraqes disa pasazhe relevante nga marrja e tij në pyetje:

....(hiqet)...

Prokurori Publik: A keni makinë?

Selami Beqiri: Po.

Prokurori Publik: Të çfarë tipi?

Selami Beqiri: Golf, ngjyrë jeshile.

Prokurori Publik: Kush e vozit makinën?

Selami Beqiri: Unë, dhe herë pas here, edhe djali im.

.....(hiqet).....

Prokurori Publik: A mund të na tregoni se çfarë ka ndodhur me makinat tuaja më 9 qershor?

Selami Beqiri: Ma vodhën makinën.

Prokurori Publik: A e mësove se kush ta vodhi makinën?

Selami Beqiri: Jo.

Prokurori Publik: Kur e more vesh që nuk e kishe makinën?

Selami Beqiri: Pasdite.

Prokurori Publik: Çfarë bëre deri atëherë?

Selami Beqiri: Po punoja në fushë.

Prokurori Publik: Në çfarë ore dole nga shtëpia jote?

Selami Beqiri: Me sa më kujtohet, ishte ora 7.30, nuk më kujtohet mirë.

Prokurori Publik: Kur shkove në fushë në orën 7.30, a e pe makinën në oborrin tënd?

Selami Beqiri: Nuk e pashë.

Prokurori Publik: Kur e more vesh se ta kishin vjedhur makinën?

Selami Beqiri: Pasdite.

Prokurori Publik: Kur shkove në fushë, a ishte makina atje?

Selami Beqiri: Jo.

Prokurori Publik: Pastaj, a u përpoqe të merrje vesh se ku ishte makina?

Selami Beqiri: Jo, sepse shpeshherë djali im e merr makinën në shkollë.

Prokurori Publik: Çfarë bëre ti kur e kuptove që nuk e kishe makinën?

Selami Beqiri: Shkova në polici dhe e raportova të zhdukur.

...(hiqet)....

Prokurori Publik: A e njihni Fikret Maratin?

Selami Beqiri: E njoh, por nuk kam biseduar kurrë me të.

....(hiqet)...

Prokurori Publik: Haki Isufin?

Selami Beqiri: Ai është kunati im.

.....(hiqet).....

Andrea Cruciani: A mund ta përsërisni për ne sa ishte koha me saktësi, kur u larguat nga shtëpia juaj më 9 qershor 2008?

Selami Beqiri: Duhet të ketë qenë ora rreth 7.30 paradite.

Andrea Cruciani: Në ç'orë fillon shkolla e djalit tuaj?

Selami Beqiri: E di që ata nisen prej orës 7.30 paradite.

Andrea Cruciani: Sa larg është shkolla?

Selami Beqiri: Rreth një kilometër e gjysëm.

Andrea Cruciani: Pra, a i duhet ta marrë makinën në shkollë?

Selami Beqiri: Ai e merr atë ndonjëherë.

Andrea Cruciani: A ishte djali juaj 13 vjeç në kohën kur ka ndodhur ngjarja?

Selami Beqiri: Mendoj se po.

Andrea Cruciani: A e vozit makinën në moshën 13 vjeçare?

Selami Beqiri: Po.

Andrea Cruciani: A e ka patentën?

Selami Beqiri: Jo.

Andrea Cruciani: A e merr makinën shpesh në shkollë meqë është 13 vjeç?

Selami Beqiri: Po, sepse ai ka vozitur traktor që kur ka qenë i vogël.

Andrea Cruciani: Ju thatë më parë që nuk e morët traktorin, meqë kushton shumë për ta çuar në fushë për një kilometër; a nuk kushton shtrenjtë të marrësh makinën në shkollë për një kilometër?

Selami Beqiri: Po, por ai është fëmijë dhe nuk kupton.

Andrea Cruciani: Kush paguan për naftën?

Selami Beqiri: Paguaj unë.

Andrea Cruciani: Në ç'orë mbaron shkolla?

Selami Beqiri: Dikur pasdite.

Andrea Cruciani: A e solli makinën në shtëpi pas shkollës?

Selami Beqiri: E ke fjalën për atë ditë?

Andrea Cruciani: Po.

Selami Beqiri: Unë thashë që mendova se djali im e kishte marrë makinën në shkollë atë ditë, por ai nuk e kishte marrë.

Andrea Cruciani: Kur u ktheve nga fusha?

Selami Beqiri: Pasdite, por nuk e di kohën e saktë.

Andrea Cruciani: Si e more vesh që ta kishin vjedhur makinën?

Selami Beqiri: Kur u ktheva kujtova se ishte djali im, por ai tha që nuk e kishte marrë.

.....(hiqet).....

Kryetari i Trupit Gjykses: Ndoshta na e keni thënë këtë tashmë, por a i lini çelësat e makinës në makinë?

Selami Beqiri: Po, dhe brenda oborrit tim.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dera e makinës lihet e pambyllur me çelës?

Selami Beqiri: Çelësat janë në makinë.

Selami BEQIRI ka deklaruar se më 9 qershor 2008, u vodh makina e tij, një Golf me ngjyrë jeshile, me numër targe 202-KS-943. Ai deklaroi se e kishte kuptuar këtë gjë vetëm pasdite pasi ishte kthyer nga fusha, kur djali i tij, që ai mendoi se do ta kishte marrë atë në mëngjes, i tregoi atij se nuk e kishte përdorur atë ditë. Është besimi i kësaj Gjykate se deklaratat e BEQIRIT nuk janë të besueshme, dhe se ato nuk përputhen me realitetin e ngjarjeve. Do të ishte e kundërllogjikshme dhe jo realiste, që kryesisht e vjedhjes së bankës që do të ndodhte në Ferizaj, do të shkonin për të vjedhur një makinë që do të përdorej për një vjedhje në fshatin Sllatinë e Epërme, që është më shumë se dhjetë (10) kilometra larg nga Ferizaji. Në të vërtetë, Selami BEQIRI, që është kunati i Haki ISUFIT, ishte kontaktuar më parë nga Fikret MURATI dhe kishte rënë dakort tua jepte makinën kryesve të veprës penale, me marrëveshjen që më vonë pasdite ai do të shkonte në polici dhe do ta raportonte atë të vjedhur. Për më tepër, nuk është e besueshme që djali i të pandehurit, që ishte trembëdhjetë (13) vjeç, e kishte marrë makinën në mëngjes në orën 07:30 për të shkuar në shkollë, e cila gjendet një kilometër e gjysëm larg nga shtëpia e familjes. Veçanërisht, siç e ka pohuar edhe vetë babai se ai nuk e përdori traktorin në po të njëjtën ditë për të shkuar në fushë, e cila gjendet po ashtu larg rreth dy kilometra, sepse kushtonte më lirë po të shkoje në këmbë. Në atë aspekt, edhe dëshmitarët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë deklaruar se e kishin parë djalin e të pandehurit të voziste traktorin ndonjëherë, por nuk e kishin parë kurrë të voziste makinën. Së fundmi, në lidhje me besueshmërinë e deklaratave të të pandehurit, është shumë e vështirë të imagjinosh se dikush gjithnjë do ta lerë makinën, edhe gjatë natës, me

dyert e hapura dhe me çelësat e makinës në të, veçanërisht meqë oborri me porta ishte lënë po ashtu hapur.

Dëshmitarët e thirrur nga mbrojtja nuk kanë dhënë deklarata të cilat mund të konsiderohen si mjafit të përshtatshme.

Në veçanti, dëshmitari ^{N.H} [redacted] një bujk nga i njëjti fshat me Selami BEQIRIN, mban mend të ketë punuar me të në fushë nga ora 08:30 deri në orën 14:00, një ditë në qershor. Dëshmitari nuk ka mundur të mbajë mend cilën ditë në qershor.

Ky është pasazhi përkatës i dëshmisë:

Bajram Krasniqi: Të mos shkojmë në detaje për shkak të gjendjes së dëshmitarit, por a i kujtohet atij se në cilën ditë e ka marrë Selamiun me traktorin e tij?

N-H [redacted] Nuk më kujtohet.

Bajram Krasniqi: A ju kujtohet ta keni marrë z. Selami disa herë?

N-H [redacted] Po.

Bajram Krasniqi: Atë ditë që ju e morët, a ju kujtohet nëse ai ka qenë i shoqëruar nga dikush tjetër? Me kë ishte Selami atë ditë?

N-H [redacted] Ai ishte i shoqëruar nga gruaja a tij.

Bajram Krasniqi: Pasi i more ata, ku shkove?

N-H [redacted] Ne shkuam bashkë që të punonim tokën.

Bajram Krasniqi: A të tregoi Selamiu se ku po shkonte kur e more me gruan e tij?

N-H [redacted] Unë vetëm e çova në fushë ku supozohej që ai do të punonte.

Bajram Krasniqi: Sa ishte ora kur e morët atë?

N-H [redacted] 8.30.

Bajram Krasniqi: Sa kohë qëndruat në fushë duke punuar?

N-H [redacted] Ne punuan deri në orën 02:00 pasdite, pastaj filloi të binte shi. Prandaj u larguam nga fusha.

H.A.

Dëshmitari [redacted] është referuar vetëm një rasti në qershor kur Selami BEQIRI kishte blerë disa materiale nga dyqani i tij. Edhe në këtë rast, po ashtu, dëshmitari nuk ishte në gjendje të mbante mend se cilën ditë në qershor kishte ndodhur kjo:

Bajram Krasniqi: A ka ardhur ndonjëherë Selamiu në dyqanin tuaj për të blerë diçka?

H-A [redacted] Disa herë kur kalon aty pari, ai blen gjëra.

Bajram Krasniqi: A ju kujtohet hera e fundit kur ai ka blerë gjëra në dyqanin tuaj?

H-A [redacted] Hera e fundit ka qenë në qershor kur ne po punonim në fushë. Është një veprimtari e veçantë që ndodh.

Bajram Krasniqi: Herën e fundit që ka qenë në dyqanin tuaj, çfarë bleu ai?

H-A [redacted] Bleu dy lëngje frutash dhe një pako cigare.

Deklaratat e të bashkë-akuzuarit Fikret MURATI të dhëna policisë më 10 qershor 2008, qartësojnë rolin e Selami BEQIRIT në ngjarje. Deklaratat në fjalë janë raportuar tërësisht më sipër, kështu që tani po përmend vetëm një pasazh përkatës:

Me cilin ra dakort Selamiu tua jepte makinën grabitësve të bankës?

-Hakiu më that ë merrja në telefon Selamiun (me telefonin tim), të shkoja në Tërpezë dhe të arrija një marrëveshje me të lidhur me makinën.

-A ishit ju aty kur arriti Selamiu dhe çfarë u bisedua aty?

-Selamiu erdhi në Tërpezë të dielën, dhe unë, Hakiu e Selamiu u takuam në fshat. Atje ata të dy u morën vesh që Selamiu do ta linte makinën në oborr të shtëpisë të pambyllur me

çelës, si edhe që do t'i linte çelësat në makinë, që të vinte Xhelali e ta merrte në mëngjes. Dhe kështu u vendos, që Selamiu të linte makinën siç kishin rënë dakort.

-A u diskutua me Selamiun se çfarë do të bëhej me makinën?

-Po, Hakiu i tha Selamiut që: "Rreth orës 09:30 ti shko në polici dhe raportoje makinën tënde të vjedhur", dhe Selamiu pranoi.

Në fakt, nga tabulatet telefonike del se i pandehuri Selami BEQIRI pati kontakte telefonike, në mbrëmjen e datës 8 qershor 2008, edhe me Faruk ADEMIN dhe me Fikret MURATIN.

Nga të gjitha pjesët e mësipërme të përmendura të provave, Gjykata ka arritur në përfundimin se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, përgjegjësia penale e të pandehurit Selami BEQIRI. I pandehuri ka siguruar ndihmë, sipas Nenit 25 të KPK për kryesit e veprës penale, e cila me të drejtë do të kualifikohet si Grabitje, sipas Nenit 255 (1)-(3) të KPK, duke përmbushur si elementin material (*actus rei*) ashtu edhe elementin psikologjik (*dolus*) të një krimi të tillë. Ai ka qenë personi që ka siguruar makinën Golf, ngjyrë jeshile, me numër targe 202-KS- 943, për Xhelal AZIZIN, kryesin e veprës penale, dhe makina është përdorur gjatë së njëjtës grabitje banke, me marrëveshjen paraprake se në po të njëjtën ditë ai do të shkonte më vonë për të raportuar rastin në polici, lidhur me makinën e tij të vjedhur.

7. Përgjegjësia penale e Faruk ADEMIT.

Edhe i pandehuri Faruk ADEMI është përgjegjës për grabitjen e bankës Pro Credit të datës 9 qershor 2008. Me të vërtetë, me kërkesën e bashkëpunëtorit, Fatos AZIZI, ai u bashkua me bashkëkryesin e veprës penale, Xhelal AZIZI në pyll, me makinën e tij, një automjet Opel Vektra, me qëllim që të fshihte atje dy çantat e bankës Pro-Credit dhe t'i vendoste paratë në një çantë sportive me ngjyrë qershie.

Më 7 qershor 2008, i pandehuri Faruk ADEMI, në prezencën e avokatit mbrojtës që kishte zgjedhur vetë, z. Sahit MUSA, dha deklaratën e mëposhtme:

"Fatos Azizi është shoku im. Ditën kur ndodhi grabitja e bankës në Ferizaj, ai më kërkoi që të shkoja me të në Ferizaj, sepse dikush i kishte para borxh. Rreth orës 07.00 paradite, unë me makinën time, "Opel Vektra", ngjyrë qershir dhe Fatosi me makinën e tij "Golf" ngjyrë të bardhë, u nisëm për në Ferizaj. Që të dy ne jetojmë në fshatin Kabash, Komuna e Vitisë. Kur arritëm në Ferizaj, Fatosi më tha se duhet të prisja afër spitalit, tek Qendra Shëndetësore, që gjendet në rrugën e Gjilanit. Që në momentin që u nisëm, Fatosi më tha të prisja aty, në atë vend.

Përveç meje dhe Fatosit që kishim udhëtuar me makinat tona, ishte edhe një makinë tjetër "Mercedes". Disa nga shokët e Fatosit që unë nuk i njihja. Unë shkova tek ai vendi ku më tha Fatosi të shkoja, por ata shkuan diku tjetër. Nuk e di se ku. Kam pritur për rreth gjysëm ore. Kur erdhën, kishte edhe disa burra të tjerë, por Fatosi nuk ishte me ta. Këta dy personat erdhën me një Golf jeshil. Kishte dy njerëz që unë nuk i njihja. Në fillim ata hapën bagazhin e makinës sime dhe vendosën dy çantat, ndërsa unë po qëndroja brenda në makinë. Njëri prej tyre hyri në makinën time dhe kishte në dorë një

revolver, ndërsa personi tjetër qëndroi në makinën "Golf". Sapo hyri në makinë ky person më urdhëroi me zë të lartë "Largohu shpejt!". Ne u nisëm për Viti dhe kur arritëm në fshatin Zllatar ai më that ë ndaloja makinën. Vendi ku kishim ndaluar ishte një pyll. Pasi ndaluan atje ky person i tërhoqi të dyja çantat nga bagazhi i makinës, i hapi ato me forcë, nxorri paratë dhe i vendosi ato në një çantë tjetër, të cilën e mori me vete. Ai nuk i numëroi paratë, por menjëherë ne u larguam në këmbë. Pas pak, ne ndaluan përsëri praën një pylli tjetër. Ai e hapi çantën dhe nxorri një sasi parash e i futi në xhep. Ai mori para e më dha edhe mua. Ai më dha mua 3.000 Euro dhe disa dollarë. Nuk e di se sa. Këto para duhet t'i fusja në xhep.

Pas kësaj, përsëri ky person më urdhëroi të ecja me të, kështu që unë vazhdova dhe ne ecëm deri afër fshatit Tërpezë. Në fakt, ky person më mori me forcë. Unë kisha frikë prej tij, sepse ai kishte një revolver me vete. Gjatë rrugës unë i thashë atij disa herë se do të kthehesha, dhe menjëherë ai më tha të shkoja. Unë shkova në rrugën e Sllakovcit, hypa në një traktor, dhe pastaj me makinën e personit të panjohur shkova në shtëpi. Pas bisedës, Fatosi erdhi tek unë me makinë. Atje Fatosi më thirri, dhe pas bisedës më mori dhe me makinën e tij shkuam në fshatin Zllatar për të marrë makinën time. Gjatë rrugës unë i tregova atij gjithçka që kishte ndodhur duke e bërë atë me faj.

Në fillim Fatosi nuk më premtoi mua para, dhe nuk më tregoi kurrë për grabitjen e bankës, por tani Fatosi më dha 1000 Euro. Pas dy orësh Fatosi i sollti paratë në shtëpi. Gjithashtu unë i tregova Fatosit se kasha marrë edhe para të tjera nga ai personi me të cilin kisha udhëtuar.

Të nesërmen, unë shkova tek shokët e mi, në fshatin Mirosal. Policia më mori në telefon dhe pastaj m'u desh të dorëzohesha vetë, të dorëzoja paratë dhe t'i shoqëroja oficerët e policisë aty ku ishim lënë çantat e bankës me para.

I pandehuri u përgjigjet kështu pyetjeve: kur Fatosi më dha 1000 Euro, nuk më tha se ku i kishte marrë ato para. Përveç Fatosit, unë nuk njoh asnjërin prej këtyre njerëzve ndaj të cilëve po zhvillohen hetimet, duke përfshirë edhe veten. Në momentin që personi hyri në makinën time ai nuk kishte doreza apo maskë. Gjatë rrugës ky person më tha se i kishte harruar dorezat në një makinë tjetër, ai më kërkoi telefonin që të fliste me dikë, por kur e mori telefonin, më tha se nuk e dinte numrin e tij të telefonit.

Pyetjes së avokatit të tij mbrojtës, i pandehuri iu përgjigj: pot a dija se atë ditë po planifikohej grabitja e bankës, nuk do të pranoja kurrë të shkoja me ta. Dy personat me makinën Golf erdhën shumë shpejt, edhe ata më tejkalan mua (makinën time), sepse ata nuk e didnin që unë isha personi që po prisja për ta. Në fshatin Zllatar ai i lëvizi paratë nga dy çantat në një çantë tjetër. Pasi ne u larguam, ai u kthye përsëri dhe i mbuloi çantat me lis. Që në fillim ky person erdhi duke bërtitur, sepse dukej që të dy ata kishin planifikuar të hynin në makinën time, por në fund njëri prej tyre u largua. Personi që udhëtoi me mua, e mbajti revolverin në dorë që kur hyri në makinë. Që në momentin që e kam kuptuar se çfarë ka ndodhur, më vjen keq për atë që kam bërë.

Kjo është deklarata ime. Nuk kam asgjë tjetër për të deklaruar. Deklarata më është lexuar dhe unë e nënshkruaj atë pa vërejtje."

I pandehuri Faruk ADEMI është marrë në pyetje po ashtu në Gjykatë. Ky është një pasazh nga procesverbali i marrjes së tij në pyetje:

Prokurori Publik: Ku jetoni?

Faruk Ademi: Në fshatin Kabash.

Prokurori Publik: A e njihni Fatos Azizim?
Faruk Ademi: Po.
Prokurori Publik: Nga është ai?
Faruk Ademi: Nga i njëjti fshat.
Prokurori Publik: Ditën e ngjarjes, kur u larguat nga shtëpia juaj?
Faruk Ademi: Nuk jam i sigurt, rreth orës 7.30.
Prokurori Publik: Me kë u largove?
Faruk Ademi: Unë isha në shtëpinë time.
Prokurori Publik: Përse shkuat në Ferizaj?
Faruk Ademi: Të blija disa pllaka.
.....(hiqet).....
Prokurori Publik: Çfarë makine po vozisje kur u nise për në Ferizaj?
Faruk Ademi: Makinën time, një makinë Opel Vektra, që është ngjyrë vishnje.
Prokurori Publik: A ishte dikush tjetër me ju?
Faruk Ademi: Jo, unë u nisa vetëm.
Prokurori Publik: Gjatë hetimit ju deklaruat se Fatos Azizi u largua gjithashtu me makinën e tij.
Faruk Ademi: Unë e kam bërë këtë deklaratë në polici, sepse ata më kanë detyruar të thoja atë që më thanë ata. Sa për prokurorinë, unë nuk e dija se si do të zhvilloheshin gjërat, dhe as nuk e dija që kasha të drejtën të mbroja veten.
Prokurori Publik: A shkuat në Ferizaj?
Faruk Ademi: Po.
Prokurori Publik: Çfarë bëtë atje?
Faruk Ademi: Unë po kërkoja disa pllaka që më mungonin.
Prokurori Publik: A e parkuat makinën diku?
Faruk Ademi: Po.
Prokurori Publik: Ku?
Faruk Ademi: Përpara një dyqani pllakash.
Prokurori Publik: Gjatë hetimit, ju deklaruat se Fatos Azizi ju tha ta prisnit përpara qendrës shëndetësore në Ferizaj.
Faruk Ademi: Ju thashë edhe më parë që nuk e dija se mund ta ndryshoja deklaratën time, sepse ata do të më kishin kthyer përsëri në polici e do të më kishin rrahur.
Prokurori Publik: Kur e keni bërë këtë deklaratë a kishit avokat mbrojtës prezent, apo jo?
Faruk Ademi: Avokati mbrojtës nuk më ka thënë që unë mund ta ndryshoja deklaratën time.
Prokurori Publik: A e zgjodhët këtë avokat mbrojtës, apo u caktua sipas detyrës zyrtare?
Faruk Ademi: Ma gjeti gruaja ime.
Prokurori Publik: Ju po thoni sot se ndaluar përpara një dyqani. Pastaj, çfarë ndodhi?
Faruk Ademi: Në momentin që u përpoqa të hyja në makinë, ai erdhi pas meje dhe më bllokoi.
Prokurori Publik: Çfarë lloj makine?
Faruk Ademi: Një e verdhë.
Prokurori Publik: Ç' doni të thoni me të verdhë?
Faruk Ademi: Më vjen keq, doja të thoja blu.
Prokurori Publik: Çfarë lloj makine?
Faruk Ademi: Nuk e di.
Prokurori Publik: Çfarë ndodhi?
Faruk Ademi: Një person nga ajo makinë doli jashtë dhe u fut në pjesën e prapme të makinës sime.
Prokurori Publik: A i njihje ata?
Faruk Ademi: Jo.
Prokurori Publik: Çfarë ndodhi pasi ai hyri në makinën tuaj?
Faruk Ademi: Ai vetëm hapi pjesën e prapme (derën) dhe hyri brenda.
Prokurori Publik: A kishte diçka me vete?
Faruk Ademi: Po, ai kishte dy çanta dhe kur hyri brenda ai më that ë vozisja.
Prokurori Publik: Çfarë bëri ai me çantat?
Faruk Ademi: Ai i vendosi ato në sediljen e prapme dhe kishte një revolver në dorë.
Prokurori Publik: A tha diçka ai?
Faruk Ademi: Ai më that ë mos e ktheja kokën, vetëm të vozisja.
Prokurori Publik: A të tha se për ku të vozisje?

Faruk Ademi: Ai më that ë ndiqja rrugën e Gjilanit.

Prokurori Publik: Ku shkuat ju?

Faruk Ademi: Kur arritëm në fshatin Dardania, që më parë quhej Tankosiç, ai më that ë kthehesha në të majtë në një rrugë të pashtruar.

Prokurori Publik: Si të urdhëroi?

Faruk Ademi: Ai më tha: "Kthehu në të majtë!"

Prokurori Publik: Dhe ju shkuat atje?

Faruk Ademi: Ne vazhduam për një kilometër dhe në anë të rrugës gjendej një mal; aty, ai më tha të ndaloja.

Prokurori Publik: Çfarë bëri ai?

Faruk Ademi: Mori çantat dhe doli nga makina.

Prokurori Publik: Çfarë bëri ai me çantat?

Faruk Ademi: Ai i mori ato dhe vazhdoi të ecte në mal dhe unë shkova në shtëpi me makinën time. Kur arrita në shtëpi pashë prapa makinës sime se mos kishte lënë gjë, si armë apo diçka tjetër. Pashë që nuk kishte armë, por që kishte ca para nën karriken ku isha ulur unë.

Kryetari i Trupit Gjykes: Sa para?

Faruk Ademi: Nuk e di.

Prokurori Publik: Si u kthyet në shtëpi atë ditë?

Faruk Ademi: Me makinën time.

Prokurori Publik: Unë vetëm mund t'ju them se ju keni dhënë një deklaratë krejt të ndryshme nga ajo që keni dhënë në prokurori, të datës 7 korrik 2008. Nëse Gjykata më lejon, unë mund tja përkujtoj të pandehurit deklaratën e asaj dite.

Kryetari i Trupit Gjykes: Po.

.....(hiqet).....

Prokurori Publik: Përveç Fatosit, a i njihni personat e tjerë këtu?

Faruk Ademi: Nuk i kam parë kurrë më parë.

.....(hiqet).....

Sulejman Nuredini: Ju përmendët që dikush ju dha para?

Faruk Ademi: Jo.

Sulejman Nuredini: Cila është e vërteta? A ju dha dikush para, apo i la dikush paratë?

Faruk Ademi: Kur u ktheva në shtëpi, unë pashë paratë të vendosura prapa karrikes sime.

Sulejman Nuredini: Ku ishin vendosur paratë? Brenda kujt ishin vendosur ato?

Faruk Ademi: Paratë ishin vendosur në vendi i këmbëve të karrikes tjetër, nga pas.

Sulejman Nuredini: A ishin vendosur këto para brenda ndonjë çante, apo diçka të tillë?

Faruk Ademi: Jo, paratë ishin përtokë.

Sulejman Nuredini: Siç e thatë edhe ju, ju pastaj i fshehët këto para?

Faruk Ademi: Mendova që ky person do të kthehej dhe do të m'i kërkonte ato para.

Sulejman Nuredini: A është kjo përse ju i fshehët paratë në atë oborr?

Faruk Ademi: I nxorra paratë nga xhepi dhe i fsheha ato jo shumë larg vendit ku po punoja.

Është bindja e kësaj Gjykate që deklaratat e Faruk ADEMIT të dhëna në Gjykatë nuk janë të besueshme dhe se ato nuk përputhen me realitetin e ngjarjeve. Historia e makinës së tij që u ndalua nga një person i panjohur i armatosur, dhe fakti që ky person e detyroi atë të shkonte në pyll, thjeshtë nuk është e besueshme. Do të ishte e kundërllogjikshme dhe jo realiste që kryesit e veprës penale të grabitjes së bankës të mos organizonin transportin e duhur dhe në vend të tij të ndërmerrnin rrezikun të ndalonin një makinë në një rrugë publike. Edhe më pak e besueshme është fakti që një nga kryesit e veprës penale të linte sasinë prej 3.000 (tre mijë) Euro pas karrikes së shoferit. Së fundmi, Gjykatës nuk i është dhënë asnjë shpjegim i arsyeshëm nga i pandehuri për ndryshimin e deklaratave të dhëna tek prokurori publik. I pandehuri deklaroi se ai nuk kishte dijeni që mund të ndryshonte deklaratën e tij në një fazë të mëvonshme, dhe se e kishin detyruar të nënshkruante deklaratat, nga frika se mund të rrihej nga policia. Në këtë aspekt, mjafton

të thuhet se avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij ishte prezent në kohën kur janë marrë deklaratat nga Prokurori Publik.

Në fakt, Faruk ADEMI, i cili është bashkëpunëtor (punon bashkë) me Fatos AZIZIN, ishte kontaktuar më herët nga ky i fundit, dhe kishte pranuar të bashkohej me Xhelal AZIZIN në pyll, me makinën e tij, një automjet Opel Vektra, me qëllim që të gërmonin atje çantat e bankës Pro-Credit dhe t'i linin paratë në një çantë sportive me ngjyrë qershie. Si shpërblim, atij iu dha shumë prej 3.000 Eurosh dhe disa dollarë amerikanë. Këto para u zbuluan më vonë dhe u sekuestruan, si rrjedhojë e një bastisjeje të kryer nga policia, siç tregohet edhe në fotografitë 136-143, 152 të raportit kriminalistik të policisë VN#46-08 të datës 9 qershor 2008.

Për më tepër, deklaratat e Fikret MURATIT të dhëna në polici më 10 qershor 2008, hedhin dritë gjithashtu edhe mbi rolin dhe përgjegjësinë e Faruk ADEMIT në grabitjen e bankës. Këto deklarata janë raportuar tashmë tërësisht më sipër, kështu që po përmend vetëm një pasazh përkatës:

-Deri në çfarë mase ka qenë Fatosi i përfshirë në këtë çështje?

-Me sa e di unë, Fatosi gjeti personin, detyra e të cilit ishte t'i merrte ata nga Ferizaji dhe për këtë ai do të merrte 10000 Euro, dhe nga këto para, Fatosi supozohej të paguente personin me makinë Vektra.

-A e dini nga është personi me makinën Vektra?

-Me sa di unë, ai ishte nga fshati Kabash, në Viti, por nuk e di emrin e tij.

Së fundmi, rezultatet e tabulateve telefonike të bisedave, tregojnë një numër kontaktesh telefonike mes Faruk ADEMIT dhe bashkëpunëtorëve, erpetrators, Fikret MURATI e Fatos AZIZI, më 9 qershor 2009, duke filluar nga ora 08:19, afërsisht dhjetë (10) minuta pasi ndodhi grabitja e bankës.

Në veçanti, nga tabulatet telefonike të bisedave:

Më 09.06.2008 në orën 08:19:52 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 08:31:44 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 08:46:10 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 09:46:10 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 09:51:08 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:01:15 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:12:29 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:16:22 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:11:58 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:13:56 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 10:26:04 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 11:10:15 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 11:38:02 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 20:52:37 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 20:59:51 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 21:06:24 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 21:07:48 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 21:09:27 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 21:10:39 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fatos Azizin në numrin 49668 [redacted]
Më 09.06.2008 në orën 21:23:37 numri 44783 [redacted] ka telefonuar Fikret Muratin në numrin 44534 [redacted]

Kur është marrë në pyetje nga Gjykata, i pandehuri, nuk ka qenë në gjendje të japë një shpjegim të arsyeshëm në lidhje me telefonatat me Fikret MURATIN, së pari duke mohuar që këto telefonata kishin ndodhur, kur u përball me rezultatet e tabulateve të bisedave telefonike, duke deklaruar se fëmijët e tij ndonjëherë luanin me telefonin e tij.

Një pasazh nga procesverballi i marrjes në pyetje, si më poshtë vijon:

.....(hiqet).....

Andrea Cruciani: A e njihni Fikret Muratin?

Faruk Ademi: Jo.

Andrea Cruciani: A e keni marrë ndonjëherë në telefon?

Faruk Ademi: Jo, nuk e kam marrë asnjëherë.

Andrea Cruciani: Cili është numri juaj i telefonit?

Faruk Ademi: Nuk më kujtohet, kanë kaluar 9 muaj tashmë.

Andrea Cruciani: Po tua them numrin, a do ta njihni?

Faruk Ademi: Ndoshta.

Andrea Cruciani: Numri është 044 783 [REDACTED]

Faruk Ademi: Po, ai është numri im.

Andrea Cruciani: Numri juaj ka qenë subjekti i përgjimeve telefonike. Ju keni pasur kontakte telefonike me Fikret Muratin më 9 qershor 2008 rreth 8 herë. A mund t'ia shpjegoni këto telefonata Gjykatës?

Faruk Ademi: Ndërkohë që ky person hyri në makinën time, ai më pyeti nëse kisha telefon. Ia dhashë atij telefonin tim.

Andrea Cruciani: Për cilën ditë po flisni?

Faruk Ademi: I referohem ditës që ky person hyri në makinën time.

Andrea Cruciani: Cilës ditë?

Faruk Ademi: Nuk më kujtohet.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ditën e grabitjes?

Andrea Cruciani: Në pfarë kohe ndodhi kjo ngjarje, kur hyri personi në makinën tuaj?

Faruk Ademi: Në mëngjes, rreth orës 9. Nuk më kujtohet. Ndoshta ishte ora 8 ose 9.

Andrea Cruciani: Telefonata e parë është në orën 8.19. Kjo telefonatë është bërë 10 minuta pasi ka ndodhur grabitja e bankës. Telefonata e fundit është bërë në orën 10.16.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është një periudhë prej dy orësh.

Faruk Ademi: A mund të kem të drejtën të di se cilin numër kam telefonuar në këtë kohë?

Andrea Cruciani: Numrin e një personi Fikret Murati. Numri është 044 53 4 [REDACTED]

Faruk Ademi: Nuk e njoh numrin e tij. E kam këtë numër në librin tim të kontakteve si një nga kontaktet e mia.

Andrea Cruciani: Ju thoni që telefoni juaj u mor nga personi që hyri në makinën tuaj?

Faruk Ademi: Po.

Andrea Cruciani: Në të njëjtën ditë ju keni marrë disa mesazhe SMS në telefonin tuaj nga Fikret Murati. I njëjti numër. Si është e mundur kjo?

Faruk Ademi: Unë nuk e njoh Fikret Muratin. Me sa më kujtohet erdhi një mesazh në telefonin tim. Nuk më kujtohet përmbajtja e tij.

Andrea Cruciani: Përmbajtja e tij ishte "ku je?"

Faruk Ademi: Nuk më kujtohet përmbajtja e atij mesazhi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të gjitha këto ndodhën mëngjesin e datës 9 qershor të vitit të kaluar. Sa kohë zgjati ky udhëtim në pyll dhe gjithçka që nga Ferizaji? Sa zgjati? Sa kohë qëndruat së bashku me këtë personin e keq?

Faruk Ademi: Duhet të kem qenë me të për 30 minuta. Nuk më kujtohet. Kjo është një kohë e përafërt.

Kryetari i Trupit Gjykses: Duket se telefonatat me Fikret Muratin zgjatën 2 orë. Si është e mundur kjo? Jo mesazhet, vetë telefonatat.

Faruk Ademi: Personi që hyri në makinën time kishte telefonin, por nuk e di se kë ka marrë në telefon. Unë nuk kam folur me njeri.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po për 2 orë? Ai i ka telefonuar Fikret Muratin për 2 orë, jo 30 minuta.

Faruk Ademi: Kush po e merrte në telefon atë? A më ka marrë ai në telefon, apo e kam marrë unë?

Kryetari i Trupit Gjykses: Telefoni juaj në telefonin e Fikret Muratit.

Faruk Ademi: Kur u ktheva në shtëpi mund të kena marrë fëmijët. Ata luajnë me të shpesh.

Nga të gjitha pjesët e mësipërme të përmendura të provave, Gjykata ka arritur në përfundimin se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, përgjegjësia penale e të pandehurit Faruk ADEMI. I pandehuri ka marrë pjesë në një vepër penale, e cila me të drejtë do të kualifikohet si Grabitje, sipas Nenit 255 (1)-(3) të KPK, duke përmbushur si elementin material (*actus rei*) ashtu edhe elementin psikologjik (*dolus*) të një krimi të tillë. Ai ka qenë personi që iu bashkua Xhelal AZIZIT në pyll me makinën e tij, një Opel Vektra, me qëllim që të fshihte dy çantat e bankës Pro-Credit atje dhe t'i vendoste paratë në një çantë sportive me ngjyrë qershie. Si shpërblim atij iu dhanë shumë prej 3.000 Eurosh dhe disa dollarë amerikanë.

8. Dënimi

8.1. Dënimi për Burim BERISHËN.

Në lidhje me dënimin që gjykata cakton për të pandehurin Burim BERISHA, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha akuzat, rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK, dhe veçanërisht shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, që del nga roli i tij i rëndësishëm dhe kryesor në grabitjen e bankës. Ai ka qenë personi që ka siguruar udhëzimet për të gjithë të pandehurit e tjerë dhe këto i ka bërë së bashku me të pandehurin që tashmë nuk është arrestuar ende, Xhelal AZIZIN; ka hyrë në bankë duke mbajtur një armë dhe ka marrë para nga banka. Ai ka përdorur avantazhin e pozicionit të tij si mbikqyrës i rojeve të sigurisë së bankës, me gjithë informacionin konfidencial që i ishte besuar, dhe e ka abuzuar pozicionin e tij për veprime kriminale me qëllimin për të përfutur materialisht për veten e tij.

I pandehuri nuk e ka pranuar kurrë përgjegjësinë e tij penale gjatë ndonjërisht prej fazave të procedurës penale, dhe nuk ka treguar kurrë ndonjë shenjë keqardhjeje për veprën penale të kryer.

Prandaj, në bazë të Neneve 38 dhe 71 të KPK, dënimi do të përcaktohet saktësisht, si më poshtë vijon:

- Burgim prej pesë (5) vjetësh e gjashtë (6) muajsh për akuzën e grabitjes, në kundërshtim me Nenin 255 (1) (2) dhe Nenin 23 të KPK;
- Burgim prej një (1) viti për akuzën e armëmbajtjes dhe përdorimit të paligjshëm të armëve, në kundërshtim me Nenin 328 (2) të KPK;
- Burgim prej gjashtë (6) vjetësh, si dënimin përfundimtar unik, në bazë të Nenit 71 të KPK.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

8.2. Dënimi për Haki ISUFIN.

Sa për të akuzuarin Haki ISUFI, Gjykata ka marrë në konsideratë gjithashtu të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK, dhe në veçanti shkallën e lartë të përgjegjësisë penale të tij, që del nga veprimtaria kryesore e tij e mbështetjes së veprimeve të Burim BERISHËS dhe Xhelal AZIZIT. Në veçanti, Haki ISUFI i ka kërkuar Fikret MURATIT të gjejë një person tjetër, bashkë me të cilin, Burim BERISHA do të grabiste bankën, dhe më pas ka siguruar të gjithë mbështetjen e mëtejshme ndaj Burim BERISHËS, pasi ishte kryer grabitja e bankës, me qëllim që të siguroheshin paratë. Me të vërtetë, Haki ISUFI shkoi në shtëpinë e xhaxhait të Fikret MURATIT, për të kontrolluar nëse çanta me para po ruhej atje në mënyrë të sigurt. Për më tepër, ai kontaktoi kunatin e tij, Selami BEQIRI për të siguruar një makinë që është përdorur për grabitjen e bankës.

I pandehuri nuk u ka pranuar kurrë përgjegjësinë e tij penale gjatë ndonjë faze të procedurës penale dhe nuk ka treguar asnjëherë ndonjë shenjë keqardhjeje për veprën penale të kryer.

Në bazë të Nenit 38 të KPK, dënimi për akuzën e grabitjes, në kundërshtim me Nenet 255 (1) (2) dhe 23 të KPK, do të përcaktohet saktësisht, si burgim prej pesë (5) vjetësh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

8.3. Dënimi për Fikret MURATIN.

Në lidhje me pozicionin e të akuzuarit Fikret MURATI, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK, në veçanti, referencën ndaj sjelljes bashkëpunuese të të pandehurit gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të hetimeve dhe procedurës penale. Deklaratat e të pandehurit gjatë hetimeve kanë qenë të një rëndësie të veçantë, për të hedhur dritë në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e të pandehurve të tjerë, duke e lehtësuar kështu rrjedhën e drejtësisë.

Në bazë të Nenit 38 të KPK, dënimi për veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me Nenet 255 (1) (2) dhe 23 të KPK, do të përcaktohet saktësisht si burgim prej dy (2) vjetësh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

8.4. Dënimi për Fatos AZIZIN.

Në lidhje me pozicionin e të akuzuarit Fatos AZIZI, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK dhe në veçanti rolin e tij kryesor në grabitjen e bankës, duke qenë personi, që sipas kërkesës së Haki ISUFIT, ka kontaktuar me personin me të cilin punonte, Faruk ADEMIN, që ky i fundit të bashkohej me Xhelal AZIZIN në pyll për të lënë çantat e bankës Pro-Credit dhe për të vendosur paratë në një çantë sportive me ngjyë qershie.

I pandehuri nuk u ka pranuar kurrë përgjegjësinë e tij penale gjatë ndonjë faze të procedurës penale dhe nuk ka treguar asnjëherë ndonjë shenjë keqardhjeje për veprën penale të kryer.

Në bazë të Nenit 38 të KPK, dënimi për veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me Nenet 255 (1) (2) dhe 23 të KPK, do të përcaktohet saktësisht si burgim prej katër (4) vjetësh e gjashtë (6) muajsh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

8.5. Dënimi për Selami BEQIRIN.

Në lidhje me pozicionin e të akuzuarit Selami BEQIRI, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK, dhe në veçanti, rolin e tij tejet të kufizuar në grabitjen e bankës, i cili ka qenë kryesisht në sigurimin e ndihmës kryesve të veprës penale duke u vënë atyre në dispozicion makinën e tij që do të përdorej për grabitjen e bankës.

I pandehuri nuk u ka pranuar kurrë përgjegjësinë e tij penale gjatë ndonjë faze të procedurës penale dhe nuk ka treguar asnjëherë ndonjë shenjë keqardhjeje për veprën penale të kryer.

Në bazë të Nenit 38 të KPK, dënimi për veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me Nenet 255 (1) (2) dhe 23 të KPK, do të përcaktohet saktësisht si burgim prej dy (2) vjetësh e gjashtë (6) muajsh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

8.6. Dënimi për Faruk ADEMIN.

Në lidhje me pozicionin e të akuzuarit Faruk ADEMIT, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK, dhe në veçanti, rolin e tij kryesor në grabitjen e bankës, ku ai ka qenë personi, i cili sipas kërkesës së Fatos AZIZIT, është bashkuar me Xhelal AZIZIN në pyll për të lënë çantat e bankës Pro-Credit dhe për të vendosur paratë në një çantë sportive me ngjyë qershie.

I pandehuri nuk u ka pranuar kurrë përgjegjësinë e tij penale gjatë ndonjë faze të procedurës penale dhe nuk ka treguar asnjëherë ndonjë shenjë keqardhjeje për veprën penale të kryer.

Në bazë të Nenit 38 të KPK, dënimi për veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me Nenet 255 (1) (2) dhe 23 të KPK, do të përcaktohet saktësisht si burgim prej katër (4) vjetësh e gjashtë (6) muajsh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

9. Padia Pronësore

Të akuzuarit, së bashku dhe në veçanti, do të kompensojnë palën e lënduar (bankën Pro Credit), për të gjitha dëmet e shkaktuara, të cilat janë përcaktuar, pas një kërkesë të palës së lënduar, në EURO 44.742,11 dhe në DOLLARË US 4.900. Sasia e saktë e parave që nuk janë gjetur dhe që është marrë nga i pandehuri që nuk është arrestuar ende, Xhalil AZIZI është përcaktuar në raportin e policisë 2008-CF-1336 të datës 17 qershor 2008 dhe dokumentacioni i Bankës Pro-Credit i datës 17 qershor 2008. Nga këto raporte del qartë se sasia e parave të vjedhura nga banka ka qenë: 54.896,00 EURO (arka 03), 56.222,35 EURO (arka 04), një sasi e përgjithshme prej 111.182,91 EURO; 158.993,00 USD (arka 03), 37.896,00 USD (arka 04), një sasi e përgjithshme prej 196.889,00 USD; 40,00 CHF (Franga Zviceriane) (arka 03); sasia e parave të gjetura nga policia ka qenë 66.450,80 EURO; 191.989,00 USD; 40,00 Franga Zviceriane - CHF; duke arritur kështu, një sasi të parave që ende mungon në vlerën prej 44.742,11 EURO dhe 4.900,00 USD.

10. Konfiskimi

Në bazë të Nenit 60 të KPK dhe Nenit 489 KPPK, revolveri i tipit Ceska Zbrojevka, modeli VZOR 50, kalibri 7,65 x 17 mm, numri serial D-30238 e prodhimit çek; 15 plumba të kalibrit 15 mm; automjeti Volkswagen, modeli Golf, numri i targës 202 KS 943, dhe automjeti Opel, modeli Vektra, numri i targës 344 KS 315, konfiskohen, meqë që të gjitha këto janë përdorur nga të pandehurit për të kryer grabitjen e bankës në Ferizaj.

11. Shpenzimet e Proçedurës Penale.

Në bazë të Neneve 102, Paragrafët 1 dhe 3, dhe 391, Paragrafi 1, Pika 6, të KPPK, të gjithë të pandehurit janë përgjegjës së bashku dhe në veçanti për shpenzimet e proçedurës penale dhe ata duhet t'i riimburojnë ato sipas një liste të shpenzimeve, e cila do të përcaktohet në kohën e duhur.

Në bazë të Nenit 100, Paragrafi 2, të KPPK, meqë të dhënat lidhur me sasinë e shpenzimeve mungojnë, do të përgatitet një vendim i veçantë lidhur me to.

Të pandehurit janë të detyruar të kompensojnë shpenzimet e përgjithshme të proçedurës penale, të cilat përcaktohet në shumën prej EURO 500,00.

16 mars 2009



Kryetar i Trupit Gjyqësor
Francëso FLORIT

Anëtar i Trupit Gjyqësor
Andrea CRUCIANI

Anëtar i Trupit Gjyqësor
Sylejman NUREDINI

Proçesmbajtëse
Liz BATEMAN

KËSHILLA LIGJORE:

Në bazë të Nenit 400 (1) të KPPK, ankesa mund të njoftohet brenda 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi, dhe, në përputhje me Nenin 398(1) të KPPK, ankesa duhet të dorëzohet në këtë Gjykatë brenda 15 ditësh nga data e që ky aktgjykim i dorëzohet palëve.